



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 50

Tiranë – E martë, 28 mars 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 17/2023, datë 16.3.2023	Për emërimin e zotit Ildir Gjata anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare..... 5317
Vendim i Kuvendit nr. 18/2023, datë 16.3.2023	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 11/2021, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”..... 5317
Vendim i Kuvendit nr. 19/2023, datë 16.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar..... 5319
Vendim i Kuvendit nr. 20/2023, datë 16.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 5322
Vendim i Kuvendit nr. 21/2023, datë 16.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 5322
Vendim i Kuvendit nr. 25/2023, datë 23.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 65/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik”..... 5323
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 24.3.2023	Për kalimin te Bashkia Durrës të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Qemal Mici”, Bashkia Durrës..... 5324
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 24.3.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 752, datë 19.12.2018, të Këshillit Ministrave, “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”..... 5325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 24.3.2023	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023..... 5325

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 174, datë 24.3.2023	Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025.....	5327
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 21.2.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1183 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.....	5328
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 22.2.2023	Me objekt shfuqizimin e ligjeve nr. 41/2022, datë 21.4.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 7, datë 18.3.2022, ‘Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg’”, dhe nr. 51/2022, datë 9.6.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.5.2022, ‘Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave ‘Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg’”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5334
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 23.2.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 895 (1373), datë 28.12.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5356
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 64, datë 3.3.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.....	5370
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 66, datë 3.3.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Natyre energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	5371
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 3.3.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.....	5372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 3.3.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.	5373
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 43(423), datë 31.1.2023	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mhill Degaj.....	5374
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 8, datë 10.1.2018, “Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 30.1.2018.....	5374

**VENDIM
Nr. 17/2023****PËR EMËRIMIN E ZOTIT IDLIR GJATA
ANËTAR I BORDIT TË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Zoti Idlir Gjata emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 16.3.2023.

**VENDIM
Nr. 18/2023****PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 11/2021, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË
INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR
KRIMET DHE PASOJAT E
KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”,

të ndryshuar, me propozimin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Organika e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Struktura e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**


Miraturar në datën 16.3.2023.



LIDHJA 1

Organika e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

Funksioni	Kategoria	Nr. i punonjësve
DREJTORI EKZEKUTIV	I-b	1
DREJTORIA E ARKIVIT DHE BIBLIOTEKËS		5
<i>Zëvendësdyrektor ekzekutiv dhe Dyrektor i Arkivit</i>	II-a	1
Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	III-b	1
Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	III-b	1
Specialist (katalogim, inventarizim dhe përpunim i dokumenteve)	III-b	1
Specialist Biblioteke (katalogim, Inventarizim i Fondit të Bibliotekës etj.)	III-b	1
DREJTORIA E STUDIMEVE		10
<i>Dyrektor dyrektorie</i>	II-b	1
Sektori i Kërkimit Shkencor		5
Përgjegjës sektori – studiues	III-a	1
Specialist (studiues)	III-b	1
Specialist (studiues) i ri	III-b	1
Specialist (studiues) i ri	III-b	1
Specialist i botimeve dhe redaktor letrar	III-b	1
Sektori i Edukimit dhe Informimit Publik		4
Përgjegjës sektori – studiues	III-a	1
Specialist i Projekteve Audiovizuale	III-b	1
Specialist i Marrëdhënieve me Publikun	III-b	1
Specialist – koordinator i edukimit i ri	III-b	1
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		6
<i>Dyrektor Dyrektorie</i>	II-b	1
Specialist i Financës dhe Buxhetit	III-b	1
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe sekretari/protokoll	III-b	1
Specialist jurist dhe i shërbimeve me gjyqësorin	III-b	1
Specialist IT (database ISKK/Arkivi Elektronik)	III-b	1
Shofer	KL. IV	1
PUNONJËS GJITHSEJ		22

**LIDHJA NR. 2****Struktura e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit****VENDIM
Nr. 19/2023**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 95/2016, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 12, pika 6, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Struktura e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Organika e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 16.3.2023.



Lidhja nr. 1
STRUKTURA AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



Lidhja nr. 2
ORGANIKA E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I.	Kryetar/i/ja i/e Autoritetit		1
	Sekretar/i/ja i/e Autoritetit		1
	Zëdhënës/i/ja i/e Autoritetit	II B	1
	Anëtarët e Autoritetit		4
II	SEKRETARIATI TEKNIK		
	Sekretari i Përgjithshëm	I B	1
	Drejtoria e Arkivit		11
	Drejtori	II B	1
	Sektori i Grumbullimit dhe Ruajtjes së Fondeve		4
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	3
	Sektori i Përpunimit dhe Restaurimit		3
	Përgjegjës sektori	III A	1



	Specialist	III B	2
	Sektori i Evidencës dhe Kartotekës		3
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Drejtoria e Përgjithshme e Trajtimin të Kërkesave		30
	Drejtor i përgjithshëm	II A	1
	Drejtoria e Informacionit		11
	Drejtor	II B	1
	Sektori kërkesave të palëve të prekura, të treta, bashkëpunëtorëve dhe të favorizuarve		7
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	6
	Sektori i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese		3
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Drejtoria e Verifikimit të Figurave		5
	Drejtor	II B	1
	Specialist	III B	4
	Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit të Qytetarëve Qytetar		8
	Drejtor	II B	1
	Sektori i Kërkesave për Qëllime Studimore, Media		4
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	3
	Sektori i Projekteve Studimore, Edukuese, Zhvillimore dhe Audiovizuale		3
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur		5
	Drejtor	II B	1
	Specialist	III B	4
	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës		15
	Drejtor	II B	1
	Sektori i Financës dhe Shërbimeve		7
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist i Financës	III B	1
	Specialist i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes	III B	1
	Sanitare		2
	Shofer		1
	Magazinier		1
	Sektori Juridik dhe Prokurimeve		3
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit		4
	Përgjegjës sektori	III A	1
	Specialist i Burimeve Njerëzore	III B	1
	Specialist i Arkiv-Protokollit	IV A	2



	Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Digjitalizimit dhe Sigurisë		9
	Drejtor	II B	1
	Spektori i Teknologjisë së Informacionit		3
	Përgjegjës Spektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Spektori i Sigurisë Fizike dhe Digjitale		2
	Specialist	III B	2
	Spektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes		3
	Përgjegjës Spektori	III A	1
	Specialist	III B	2
	Gjithsej		73

VENDIM
Nr. 20/2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar për Demokraci dhe Integrim,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Gëzim Ademaj caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 16.3.2023.

VENDIM
Nr. 21/2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Petrit Doda caktohet anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 16.3.2023.



VENDIM
Nr. 25/2023

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.
65/2020, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE
KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE
TË PUNËS TË KOMISIONIT TË
PROKURIMIT PUBLIK”

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 65/2020, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik” ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 23.3.2023.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 29, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”,

Lidhja nr. 1
ORGANIKA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK





Lidhja nr. 2
STRUKTURA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Pozicioni	Kategoria	Nr. punonjësish
Kryetar		1
Sekretar i kryetarit		1
Nënkryetar		1
Anëtar		3
Këshilltar	II-B	1
Sekretar i përgjithshëm	I-B	1
Drejtor	II-B	1
Inspektor	III-A	15
Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor		
Përgjegjës sektori	III-A	1
Specialist jurist	III-B	3
Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve		
Përgjegjës sektori	III-A	1
Specialist (financë)	III-B	1
Specialist (buxheti)	III-B	1
Specialist (protokolli)	IV-A	1
Specialist (sekretari/arkiv)	IV-A	1
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve	III-B	1
Specialist Integrimi/Marrëdhënieve me Jashtë	III-B	1
Sanitar		1
Shofer		1
Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit		
Përgjegjës sektori	III-A	1
Specialist (redaktor letrar)	III-B	1
Specialist Statistikash	III-B	1
Specialist (IT)	III-B	1
Specialist Publikimi	III-B	1

Gjithsej 42 punonjës

VENDIM
Nr. 167, datë 24.3.2023

PËR KALIMIN TE BASHKIA Durrës
TË OBJEKTIT ARSIMOR, SHKOLLA 9-
VJEÇARE DHE KOPSHTI “QEMAL
MICI”, BASHKIA Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te Bashkia Durrës të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare dhe kopshti “Qemal Mici”, Bashkia Durrës, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE (TABELA NR. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i Ndërtimit	Sipërfaqe (m ²)	Vlera e projektidesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe të ndërtimit	Vlera e mbikëqyrës	Vlera e kolaudimit	Vlera totale e objektit
4	Bashkia Durrës	Durrës	Durrës	9-vjeçare + kopsht	"Qemal Mici"	Ndërtim	Buxhet GoA	6,135.0	2,834,531.00	281,400,000.00	2,131,950.00	243,855.48	286,610,336.48
TOTAL								6,135.0	2,834,531.0	281,400,000.0	2,131,950.0	243,855.5	286,610,336.5

VENDIM**Nr. 171, datë 24.3.2023**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 752, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të Bordit të Apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, që i bashkëlidhet vendimit nr. 752, datë 19.12.2018, të Këshillit Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Bordi i Apelit përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë punonjës të DPPI-së dhe 3 anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së.";

b) Në fjalinë e parë, të pikës 3, numri "2" zëvendësohet me "3";

c) Në pikën 4, numri "... dy ..." zëvendësohet " ... tre ...".

2. Pika 6, e nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Kryetari i Bordit të Apelit cakton një anëtar të Bordit të Apelit, që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga

marrja e vendimit, të përgatitë vendimin e arsyetuar, një kopje e të cilit i dorëzohet sekretarit teknik nëpërmjet zyrës së protokollit për t'ia bashkëlidhur dosjes së çështjes."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 172, datë 24.3.2023**

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), si dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Lidhja nr. 1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2023

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	13	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2024–2026
Janar	27	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2024–2026
Shkurt	8	SASPAC/KM	Përgatit dhe diskuton projektdokumentin e prioritetëve të politikave 2024–2026 me ndikim në tavanet buxhetore
Shkurt	15	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2024–2026, për fazën strategjike
Shkurt	28	KM	Miraton Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare
Shkurt	28	MoFE	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Mars	8	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2024–2026
Mars–Prill	1 mars–24 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	25 prill–26 prill	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2024–2026
Maj	1	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore
Maj	2–18 maj	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	2–18 Maj	SASPAC/KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetëve të politikave 2024–2026.
Maj	19–27 maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
Maj	30–31 maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA 2024–2026 me shoqërinë civile
Qershor	1	SASPAC/KM	Përgatit dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2024–2026 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	7	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar (në rast se shihet e nevojshme)
Qershor	7	KM	Miraton dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2024–2026 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	10	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA 2024–2026 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2024–2026.
Qershor	21	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA 2024–2026 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2024–2026, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	28	KM	Miraton dokumentin e PBA 2024–2026 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2024–2026
Korrik	7	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2024–2026
Korrik	7	MoFE	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Korrik - Gusht	10 korrik – 31 gusht	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	1	njësitë e qeverisjes së përgjithshme	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	4–13	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	4–13	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioritetëve të politikave 2024–2026.
Shtator	14–22	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	25 Shtator–10 tetor	MoFE	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2024, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2024–2026 dhe i paraqet për shqyrtim në KM
Tetor	13	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2024, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2024–2026
Tetor	20	MFE	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2024–2026, të miratuar nga KM-ja
Tetor	20	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2024



VENDIM
Nr. 174, datë 24.3.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMAVE TË
MBËSHTETJES NËPËRMJET
SUBVENCIONIT PËR NDËRMARRJET
SOCIALE, PËR PERIUDHËN 2023–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, të njohura si të tilla nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, me vlerë të përgjithshme prej 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekësh, për periudhën 2023–2025, sipas produktit përkatës të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm “Përkujdesja sociale”.

2. Format e mbështetjes së ndërmarrjeve sociale nëpërmjet subvencionit janë:

a) mbështetja e hapjeve të vendeve të reja të punës, në pagesën e pagës minimale të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara;

b) mbështetja në pagesën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara.

3. Ndërmarrjet sociale që përfitojnë subvencione për krijimin e vendeve të reja të punës duhet të kenë:

a) një projektpropozim, shoqëruar me plan-biznesin 3-vjeçar;

b) dokument që vërteton rritjen e numrit të të punësuarve, me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara, të evidentuar në programet e mbrojtjes sociale dhe të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kërkesa me shkrim shoqërohet dhe me dokumentacione të tjera shtesë, si më poshtë vijon:

a) ekstraktin historik të kompanisë, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, në rast se organizata e ushtron

aktivitetin prej më shumë se një viti dhe formularët e deklarimeve dhe pagesave për personat fizikë;

c) vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për atë kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

ç) informacionin për numrin e të punësuarve dhe nivelin e pagës së dhënë për çdo person;

d) vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit të specifikuar për tre muajt e fundit;

dh) një kopje të aktit të inspektimit në punë, në rast se organizata ka ushtruar më parë aktivitetin e saj.

5. Një ndërmarrje sociale mund të përfitojë subvencion për hapjen e deri 20 (njëzet) vendeve të reja të punës, ku përfshihen pagesat e pagës minimale për punëmarrësit, për një periudhë 3-vjeçare.

6. Financimi i dy formave të subvencioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të pagës minimale dhe i sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit dhe punëmarrësit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet në masën 100%, kundrejt paraqitjes së listë-pagesave të punonjësve pranë Shërbimit Social Shtetëror.

7. Ndërmarrjet sociale që paraqesin kërkesë për mbështetjen nga format e subvencioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) nuk duhet të kenë shkelur legjislacionin e punës dhe atë tatimor, lidhur me detyrimet ndaj punëmarrësve;

b) kohëzgjatja e kontratës për të punësuarit nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet, duke garantuar qëndrueshmëri në vitet në vijim;

c) jo më pak se 50% e të punësuarve të jenë pjesë e programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.

8. Subvencionimi i ndërmarrjeve sociale në një nga format e përcaktuara në këtë vendim nuk kushtëzon të drejtën e tyre për të përfituar nga forma të tjera të mbështetjes së ndihmës shtetërore, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

9. Përjashtohen nga përfitimi i subvencionit të ndërmarrjeve sociale ato organizata jofitimprurëse, që kanë përfituar në 3 vitet e fundit nga programi i



mbështetjes financiare të buxhetit të shtetit, fondi social.

10. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje sociale, e siguruar nga të gjitha format e mbështetjes së ndihmës shtetërore, përfshirë dhe format e mbështetjes nga buxheti i shtetit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, nuk do të kalojë shumën 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë prej 3 vjetësh.

11. Ndërmarrja sociale, përfituese e formave të subvencioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, plotëson deklaratën për çdo ndihmë “*de minimis*”, të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, të përfituar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitin financiar në vazhdim.

12. Ministri përgjegjës për çështjet sociale ngre komisionin vlerësues të kërkesave të ndërmarrjeve sociale për përfitimin e subvencioneve dhe përcakton përbërjen, rregullat e organizimit e funksionimit të tij.

13. Ndërmarrjet sociale, që përfitojnë subvencione, raportojnë pranë ministrit përgjegjës për çështjet sociale lidhur me përdorimin e subvencionit të përfituar, sipas formatit të raportimit, të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

14. Periudha e raportimit të veprimtarisë është viti kalendarik, i cili është në përputhje me vitin financiar të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë për çështjet sociale, sipas produktit përkatës të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm “Përkujdesja sociale”.

16. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 7, datë 21.2.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 21.2.2023
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (A) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Dhima

SUBJEKT I INTERESUAR:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore,
Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1183 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: nenet 42, 131, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 49, pika 3, shkronja “c”, 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Aleksandër Dhima është emëruar në detyrën e oficerit të shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura me urdhrin nr. 0337, datë 28.12.1969 të ministrit të Mbrojtjes. Ai e ka kryer këtë detyrë për 23 vjet, 11 muaj e 15 ditë deri në daljen në rezervë me urdhrin nr. 3014, datë 16.12.1993 të ministrit të Mbrojtjes, për shkak të reformës në Forcat e Armatosura.

2. Kërkuesi është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 1.1.1999–6.9.1999. Më datë 6.9.1999 ai është punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe për këtë shkak i është ndërprerë pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi bazuar në nenin 11, paragrafi i katërt, të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar” (*ligji nr. 8087/1996*). Kjo dispozitë ligjore parashikonte ndërprerjen e pagesës kur përfituesi rritullohej ushtarak aktiv ose punësohej.

3. Me ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9210/2004*), hyrë në fuqi më 14.5.2004, u parashikua se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi nuk ndërpritet në rastin e punësimit (*neni 35, pika 2*). Ndërsa me ligjin nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 9418/2005*), hyrë në fuqi më 1.1.2006, u parashikua se ky lloj pensioni ndërpritej vetëm nëse ushtaraku rikthehej në shërbim aktiv dhe se masa e përfitimit nuk mund të ishte më e madhe se katërfishi i pensionit bazë (*neni 14, pikat 3 dhe 4*), ky i fundit i përcaktuar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 7703/1993*). Sipas ligjit ndryshues nr. 9481, datë 16.2.2006, masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur ushtaraku punësohej në sektorin publik, u barazua me pensionin bazë në shkallë vendi (*neni 2*).

4. Më pas, më datë 27.6.2009, ka hyrë në fuqi ligji nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10142/2009*). Neni 14, pika 4 i tij parashikon se kur përfituesi punësohet në vende të tjera pune, që nuk lidhen me funksionin e tij të mëparshëm, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet sa një pension bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703/1993.

5. DRSSH-ja, bazuar në ligji nr. 10142/2009, ka rishqyrtuar të ardhurat e tij dhe, në përfundim, me vendimin nr. 106/1, datë 30.6.2009, i ka ricaktuar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me fillim pagese nga data 1.7.2009.

6. Më datë 7.5.2015, kërkuesi ka ngritur padi me objekt rinjohjen e së drejtës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 14.5.2004–30.6.2009, bazuar në nenin 35, pika 2, të ligjit nr. 9210/2004 dhe pagimin e këtij përfitimi deri më datë 30.6.2006, së bashku me kamatat. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3688 (80-2015-2194), datë 8.7.2015, ka pranuar pjesërisht padinë, duke i njohur kërkuesit të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën e kërkuar, si dhe duke urdhëruar DRSSH-në, të llogariste masën e përfitimit sipas ligjit.

7. DRSSH-ja, ka paraqitur ankim ndaj vendimit, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në zbatimin e ligjit lidhur me formulën pa kufizim të masës së pensionit, pasi ligji nr. 9210/2004 nuk ka qenë në fuqi në kohën e daljes së kërkuesit në rezervë. Masa e pensionit të parakohshëm, sipas ligjit nr. 9418/2005, është e barabartë me pensionin bazë. Po kështu, DRSSH-ja ka parashtruar se pas vendimit nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), ajo po rillogarit masat e pensioneve të ushtarakëve dhe konflikti me kërkuesin për masën e përfitimit do të shqyrtohet në rrugë administrative prej saj.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2953, datë 13.7.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me arsyetimin se kërkuesi duhej të trajtohej



me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, bazuar në ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005, sipas të cilëve përfitimi ndërpritej vetëm kur ushtaraku përfitues rikthehej në shërbimin aktiv. Lidhur me shkaku e ngritur nga DRSSH-ja në apel se masa e pensionit do të shqyrtohej në rrugë administrative, Gjykata Administrative e Apelit ka evidentuar se mosmarrëveshja konkrete ka për objekt njohjen e së drejtës së përfitimit, ndërsa për masën e përfitimit gjykata administrative e shkallës së parë ka urdhëruar llogaritjen e saj sipas ligjit.

9. Më datë 30.7.2018 DRSSH-ja, me pretendimin e zbatimit të keq të ligjit, ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pjesën e pranuar të padisë, duke kërkuar, gjithashtu, edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Kjo kërkesë e fundit është pranuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*) me vendimin nr. 576, datë 24.10.2018. Në përfundim të shqyrtimit të rekursit Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1183 (189), datë 13.5.2022, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e gjykimit të çështjes, pasi: (i) kërkuesi në momentin e ndërprerjes së pensionit nuk kishte shteruar rrugën administrative të ankimit ndaj vendimit të DRSSH-së, bazuar në nenin 86 të ligjit nr. 7703/1993; (ii) dhe padia e tij ishte paraqitur 11 vjet pas ndërprerjes së pensionit dhe 6 vjet pas afatit fundor të pagesës, ndaj ajo ishte ushtruar jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 62, pika 3, i ligjit nr. 7703/1993.

10. Më datë 18.8.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Kolegji i Gjykatës më datë 11.11.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar ka cenuar:

11.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.1.1 *E drejta e aksesit*, pasi çështja e tij u pushua, duke mos i dhënë zgjidhje së drejtës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ankimi administrativ nuk ka qenë i detyrueshëm sipas legjislacionit të posaçëm, ndërsa e drejta e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nuk parashkruhet. Gjykata e Lartë ka cenuar *parimin e disponibilitetit të padisë*, pasi në marrjen e vendimit nuk iu referua shkaku ligjor, si dhe situatës ligjore që ekzistonte më datë 14.5.2004 kur u hoq ndalimi i pensionit të parakohshëm në rastet e punësimit të ushtarakut.

11.1.2 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në dyshim të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në rast punësimi, e cila është e drejtë e fituar nga ligjet nr. 9210/2004 dhe nr. 9418/2005.

11.1.3 *Parimi i gjësë së gjykuar*, pasi e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ka qenë objekt shqyrtimi disa herë në të gjitha shkallët e gjyqësorit deri në Gjykatën e Lartë, e cila ka mbajtur qëndrimin se kjo e drejtë mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë dhe nuk parashkruhet.

11.1.4 *E drejta për një gjykim të drejtë*, pasi gjykimi dhe vendimi janë bazuar në nenet 62 dhe 86 të ligjit nr. 7703/1993, të cilat nuk përcaktojnë pozitën juridike të ushtarakut për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, gjë e cila rregullohet nga legjislacioni i posaçëm.

11.1.5 *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi rekursi u shqyrtua pas 3 vjetësh e 10 muajve, duke tejkaluar afatin 90-ditor të parashikuar në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

11.1.6 *Parimi i paanshmërisë dhe paanësisë*, pasi Gjykata e Lartë ka paragjykuar çështjen dhe ka ndihmuar interesat e palës tjetër ndërgjyqëse. Ajo nuk ka respektuar praktikën e mëparshme të saj, pasi ka zbatuar ligjin e përgjithshëm, duke shmangur ligjin e posaçëm. Ky i fundit parashikon shprehimisht të drejtën e ankimit në gjykatë, ndaj Gjykata e Lartë ka ndryshuar bazën juridike të padisë pa kërkesë. Vendimi unifikues nr. 1, datë 26.11.2010 ka përcaktuar se ndjekja e rrugës administrative është e detyrueshme vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht. Në një rast tjetër të ngjashëm, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se e drejta për pension është e paparashkrueshme.



11.2 Të drejtën e pensionit, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën e fituar nga ligji, duke i cenuar në këtë mënyrë nivelin e jetesës, në kushtet kur kjo e drejtë nuk parashkruhet dhe legjislacioni që parashikon këtë të drejtë nuk detyron ushtrimin e ankimit në rrugë administrative.

12. **Subjekti i interesuar**, DRSSH-ja, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vëren se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar mbi të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, ndaj ai ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat

procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 56, datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, kërkuari e ka parashtruar drejtpërdrejt në ankimin kushtetues, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive të parashikuara nga nenet 399/1–399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se, si rregull, shqyrtimi i pretendimeve në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon ky kod, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, për sa kohë që kërkuari nuk i ka shteruar mjetet ligjore efektive përpara se të vinte në lëvizje gjykimin kushtetues.

17. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon se kërkuari nuk ka mjete të tjera në dispozicion, për rrjedhojë ai e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

18. Po kështu, Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.5.2022, kurse ankimi kushtetues është dërguar nëpërmjet shërbimit postar më datë 18.8.2022, brenda afatit 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar se nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar atij i janë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e aksesit, sigurisë juridike, gjësë së gjykuar, gjykimit të drejtë, paanshmërisë dhe paanësisë, si dhe e drejta për pension. Në thelb, ai kundërshton pushimin e gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë, me pretendimin se të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi e kishte fituar nga ligji, por padia e tij mbeti pa përgjigje si rezultat i interpretimit të pasaktë të ligjit mbi detyrimin për shterimin e ankimit administrativ dhe afatin e paraqitjes së padisë, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën e aksesit në gjykatë. Kërkuari, në funksion të këtij pretendimi, parashtron edhe argumentet për



sigurinë juridike, gjënë e gjuar, gjykimin e drejtë, paanshmërinë dhe paanësinë e Gjykatës së Lartë.

20. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me mënyrën e përfundimit të procesit gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuarit, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit një e drejtë e njohur me ligj nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë. Në vlerësimin e pretendimeve të kërkuarit, Gjykata evidenton se standardet kushtetuese që garantojnë procesin e rregullt ligjor dhe gjykimin e drejtë, përfshirë të drejtën për akses, janë ngushtësisht të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi edhe i vetëm njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkuarit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, e cila ka dhënë vendimin e kundërshtuar, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të së drejtës së aksesit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit

22. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke pushuar gjykimin e çështjes së tij, i ka mohuar të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 14.5.2004–30.6.2009, në masën e pensionit bazë në shkallë vendi. Sipas tij, Gjykata e Lartë në rastin e tij nuk ka respektuar jurisprudencën e saj se sipas ligjeve të posaçme nr. 8087/1996, nr. 9418/2005 dhe nr. 10142/2009, paraqitja e ankimit administrativ nuk ka qenë i detyrueshëm. Po kështu, sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë ka gabuar në përfundimin se padia e tij është parashkuar, pasi neni 31 të ligjit nr. 9418/2005 parashikon se e drejta e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nuk parashkruhet. Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e disponibilitetit të padisë, pasi ndryshoi vetë bazën juridike të zgjidhjes së çështjes, në kundërshtim me nenet 16 dhe 185 të KPC-së. Ajo nuk shqyrtoi dhe nuk vendosi për situatën ligjore që ekzistonte më datë 14.5.2004 kur kërkuarit i lindi e drejta e

mosndërprerjes së trajtimit me pension të parakohshëm.

23. Gjykata ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuari është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 1.1.1999–6.9.1999, që iu ndërpre për shkak të punësimit në sektorin publik më datë 6.9.1999. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, DRSSH-ja ka rishqyrtuar të ardhurat e kërkuarit dhe i ka caktuar atij pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me fillim pagese nga data 1.7.2009, duke mos ia njohur këtë të drejtë atij për periudhën 14.5.2004–1.7.2009. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit e kanë pranuar padinë e kërkuarit



për njohjen e së drejtës në këtë periudhë, ndërsa Gjykata e Lartë i ka prishur vendimet, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo e fundit ka arsyetuar se paditësi (kërkuesi), në kohën kur i është ndërprerë pensioni i parakohshëm, nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të DRSSH-së për këtë ndërprerje, në përputhje me parashikimet e nenit 86 të ligjit nr. 7703/1993, për rrjedhojë ai nuk mund të kërkojë gjyqësisht një të drejtë pa ezauruar më parë ankimin administrativ (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, sipas saj, padia është ushtruar më datë 7.5.2015, rreth 11 vjet pas ndërprerjes së pensionit dhe 6 vjet pas afatit fundor të pagesës që ai kërkon, kështu ajo konsiderohet se nuk është ushtruar brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar në nenin 62, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993 (*shih paragrafin 20, po aty*).

26. Gjykata vëren se gjykimi i çështjes së kërkuesit është pushuar nga Gjykata e Lartë për shkak se nuk janë plotësuar kushtet formale të shqyrtimit në themel të padisë, që lidhen me shterimin e ankimit administrativ dhe afatin e ngritjes së padisë. Ato parashikohen nga ligji si kushte për ngritjen e padisë për të garantuar respektivisht rolin subsidiar të administratës publike dhe parimin e sigurisë juridike, megjithatë duhet mbajtur në konsideratë se në thelbin e tyre, kushtet formale të paraqitjes së padisë kufizojnë me ligj aksesin në gjykatë. Për shkak të natyrës dhe rëndësisë së tyre, ligji përcakton se kushtet formale të ngritjes së padisë janë të verifikueshme nga gjykata edhe kryesisht, pa pasur nevojë për kërkesë paraprake nga palët (*shih nenet 16, 18 dhe 19 të ligjit nr. 49/2012*). Për shkak të këtyre karakteristikave, është e qartë se verifikimi i kushteve formale të padisë përbën çështje me natyrë ligjore.

27. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se në procedurën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, ligjvënësi ka parashikuar disa kërkesa specifike në nenin 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, i cili është i zbatueshëm në gjykimin administrativ, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Sipas këtyre dispozitave, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitim të parashitësive të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, neni 482/a, pika 1, shkronja “b”, i po këtij kodi, në harmoni me nenin

62, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 49/2012, parashikon se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

28. Duke iu referuar akteve në dosjen gjyqësore, Gjykata konstaton se në çështjen e kërkuesit shterimi i ankimit administrativ dhe afati i ngritjes së padisë nuk janë paraqitur si shkaqe në rekursin e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se ato janë verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë Gjykatës së Lartë në procedurën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë. Ai është vendosur në pozicionin e pamundësisë për t’u mbrojtur efektivisht për to, duke u përballur me një vendim gjyqësor, që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimit që ai kishte për të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar.

29. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor që ka vendosur për të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga ajo gjykatë, e cila duhet t’u japë atyre përgjigje të arsyetuar.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues i kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,



VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1183 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 21.2.2023.

Shpallur, më 23.3.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 8, datë 22.2.2023

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, më datë 31.1.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 5 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar nga Marash Logu, Dashnor Sula dhe Bledion Nallbati, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Irma Qosja dhe Herald Jonuzaj, me autorizim.

Faqe | 5334

AUTORITETI I KONKURRENCËS, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i ligjeve nr. 41/2022, datë 21.4.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 7, datë 18.3.2022, Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”, dhe nr. 51/2022, datë 9.6.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.5.2022, Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 11, 18, 101, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 71 i ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare” (ligji nr. 9590/2006); nenet 27, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet e jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit (kërkesë), prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (Kuvendi) dhe Këshillit të Ministrave (Këshilli i Ministrave), që kërkuar rrëzimin e kërkesës, mendimin me shkrim të Autoritetit të Konkurrencës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

**I
Rrethanat e çështjes**

1. Më datë 18.3.2022 Këshilli i Ministrave ka nxjerrë aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7 “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të



lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg” (*akti normativ nr. 7/2022*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 48, datë 30.3.2022. Objekti i tij është përcaktimi i rregullave për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg (*neni 1*). Në kuptim të këtij akti, situata e veçantë përfshin të gjitha ato raste që krijojnë situatë emergjente kur tregu i disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to karakterizohet nga: rritja e ndjeshme e çmimeve në treg të këtyre produkteve, ulja në mënyrë të ndjeshme e importeve mesatare të tyre, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar; mungesa e produkteve në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë, që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave, në përputhje me këtë akt normativ; çdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas (*neni 2, pika 1*).

2. Për zbatimin e këtyre masave, akti normativ nr. 7/2022 ka parashikuar krijimin e Bordit të Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to (*Bordi*) (*neni 3*), si organ i veçantë me kompetenca dhe përgjegjësi, ndër të tjera: të miratojë listën e produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, për të cilat zbatohet situata e veçantë; të zbatojë metodologjinë e përcaktuar për vendosjen me transparencë të plotë të marzhit të fitimit; të vendosë marzhin e fitimit në bazë të monitorimit të çmimeve të këtyre produkteve dhe njoftimit të tij në mënyrë periodike; t’i propozojë strukturës përgjegjëse marrjen e masave administrative ndaj subjekteve në rast të shkeljes së parashikimeve të aktit normativ; të monitorojë çdo javë vlerën e çmimeve të produkteve, sipas listës së miratuar prej tij; çdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në bazë të këtij akti normativ (*nenet 4 dhe 6*).

3. Akti normativ nr. 7/2022 ka parashikuar, gjithashtu, masat e veçanta administrative ose me karakter detyrues që do të merren ndaj subjekteve që importojnë dhe/ose prodhojnë produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me

to, si dhe organet kompetente për dhënien e tyre (*nenet 7, 8 dhe 9*). Po kështu, në zbatim të pikës 2 të nenit 8 të tij, të gjitha subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, objekt i këtij akti normativ, të nevojshme për furnizimin e popullatës, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë, për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg.

4. Akti normativ nr. 7/2022 është miratuar me ligjin nr. 41, datë 21.4.2022 (*ligji nr. 41/2022*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 20.5.2022.

5. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë, 11.5.2022 “Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave ‘Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg’” (*akti normativ nr. 9/2022*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 13.5.2022. Përmes tij është shtuar fjali në pikën 2 të nenit 8 të aktit normativ nr. 7/2022, duke përcaktuar se për mbajtjen e rezervave, me qëllim përballimin e situatës së krijuar në treg, Këshilli i Ministrave miraton garanci shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë, si dhe kushtet e kriteret e marrëveshjes tip të garancisë dhe marrëveshjes tip të mirëkuptimit (*neni 1*).

6. Akti normativ nr. 9, datë 11.5.2022 është miratuar me ligjin nr. 51, datë 9.6.2022 (*ligji nr. 51/2022*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 8.7.2022.

7. Më datë 19.9.2022 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar se ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022 bien ndesh me nenet 11, 17, 18 dhe 101, të Kushtetutës, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (*MSA*), të ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, Traktatin e Funksionimit të Bashkimit Evropian (*TFBE*), si dhe nenin 68 të rregullores së Kuvendit.



II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022, të miratuara me ligjet përkatëse, kanë cenuar:

8.1 *Nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*, për shkak të nxjerrjes dhe miratimit të tyre pa një analizë të elementeve kushtetuese të nevojës dhe urgjencës. Konfliktet dhe tensionet ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës nuk përbëjnë situatë krejtësisht të paparashikuar, çka nuk justifikon urgjencën me të cilën janë nxjerrë ato. Këshilli i Ministrave kishte në dorë mekanizma të tjerë ligjorë dhe institucionalë për garantimin e mbrojtjes së konsumatorit. Ai mund të paraqiste në Kuvend projektligj për shqyrtim me procedurë të përsheptuar, por ka preferuar nxjerrjen e akteve normative me fuqinë e ligjit, çka është shndërruar në rregull në praktikën qeverisëse 2013–2022. Qeveria nuk ndërmori hapa për disiplinimin e shoqërive të tregtimit me shumicë ose pakicë të lëndëve ushqimore gjatë pandemisë COVID-19, pavarësisht rritjes së produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to.

8.2 *Lirinë e veprimtarisë ekonomike*, të parashikuar në nenin 11, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, në drejtim edhe të nenit 17 të Kushtetutës. Krijimi i një bordi me pjesëmarrje publike dhe private përbën ndërhyrjen më flagrante dhe më pak të përshtatshme në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Ai nuk përbën mjet efektiv për mbrojtjen e konsumatorit nga rritja e çmimeve. Aktet normative nuk përmbushin standardin e formulimit të saktë dhe preciz të ligjit. Nenet 2, pika 1, shkronja “ç” dhe 4, shkronja “dh”, të aktit normativ nr. 7/2022, janë evazive dhe i krijojnë hapësirë qeverisë të ndërhyjë në treg me masa kufizuese ndaj operatorëve ekonomikë. Mosnënshtrimi ndaj kontrollit parlamentar i vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave për shpalljen e situatës së veçantë dhe mospërcaktimi i një afati për kohëzgjatjen e saj, duke e lënë në diskrecionin e Bordit, cenon standardin e kufizimit vetëm me ligj të së drejtës dhe parimin e proporcionalitetit, në drejtim të përkohshmërisë së kufizimit. Për përmbushjen e kriterëve të “*interesit publik*” dhe “*mbrojtjes së të drejtave të tjerëve*” qeveria mund të kishte përdorur mjete të tjera më pak

kufizuese. Masat e veçanta vazhdojnë të jenë në fuqi, pa pasur një datë ose afat për kohëzgjatjen e tyre.

8.3 *Parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi anëtarëve të Bordit, përfaqësues të shoqërive të tregtimit të produkteve ushqimore, u njihet e drejta të marrin vendime për caktimin e çmimeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të këtyre produkteve, të paraqesin të dhëna dhe informacione që ndikojnë në vendimmarrje, si dhe të marrin masa disiplinore ndaj konkurrentëve të tyre. Në kushtet e përzgjedhjes së tyre pa kriteret e qarta ligjore, lihen jashtë vendimmarrjes përfaqësues të shoqërive të importit, prodhimit dhe tregtimit të lëndëve ushqimore, që mund të hasin vështirësi dhe shqetësime të shumta në përballimin e situatës.

8.4 *MSA-në dhe TFBE-në, në lidhje me rregullat e konkurrencës*, pasi mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit nga shoqatat e biznesit dhe grupet e interesit, si dhe se çfarë kuptohet me “grupe interesi”, mbeten të papërcaktuara. Dakordësimi i këtyre anëtarëve me qeverinë për përcaktimin e çmimit të shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe atyre të lidhura me to, si dhe vendosja prej tyre e sanksioneve, bie në kundërshtim me nenin 71, pika 1, të MSA-së dhe nenin 101 të TFBE-së, pasi bëhet fjalë për marrëveshje mes ndërmarrjesh, çka është e ndaluar.

8.5 *Nenin 68, pika 2, të rregullores së Kuvendit*, pasi relacionet bashkëshoqëruese të projektakteve normative nuk përmbushin disa prej kriterëve të përcaktuara në këtë nen, konkretisht ndikimin ekonomik, social, mjedisor dhe ndjeshmërinë gjinore (*shkronja “ç”*), shkallën e përmbushjes së objektivave të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj (*shkronja “d”*), si dhe detyrimet që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma dhe akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë (*shkronja “dh”*). Mungesa e këtyre kriterëve, e pasqyruar edhe në raportin e komisionit përgjegjës parlamentar, bën që procedura parlamentare e ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e tyre të jetë me të meta. Kryetarja e Kuvendit kishte detyrimin t’ia kthente ato Këshillit të Ministrave për rregullimin e të metave.



9. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka parashtruar:

9.1 Ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022 i plotësojnë kushtet dhe kriteret që burojnë nga neni 101 i Kushtetutës. Situata emergjente për produktet ushqimore në tregun shqiptar, si rrjedhojë e situatës në tregun ndërkombëtar, ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen për rregullimin e saj. Krijimi i Bordit u bë duke pasur parasysh efektet e luftës Rusi–Ukrainë në tregje, kërkesë-ofertën e ushqimeve, kontratat e furnizimeve, çmimet e tregtimit dhe luhatjet e tyre, rritjen e çmimeve në vendet evropiane, si dhe ekzistencën e rrezikut të rritjes së pakontrolluar të çmimeve të produkteve kryesore ushqimore. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës dhe bashkimi i Republikës së Shqipërisë me partnerët ndërkombëtarë në kufizimet e vendosura ndaj Rusisë përhapin panik në popullatë, duke rrezikuar edhe sigurinë kombëtare. Deri më sot çmimi i produkteve është mbajtur nën kontroll dhe janë eliminuar spekulimet në treg, çka tregon se aktet kanë sjellë efektet e dëshiruara.

9.2 Aktet e kundërshtuara janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës dhe nuk kufizojnë *lirinë e veprimtarisë ekonomike*, por vetëm rrezikun për rritje spekulative të çmimeve për shkak të luftës në lindje të Evropës. Pretendimet e kërkuesit për paqartësinë e ligjit nuk mbështeten në një dispozitë konkrete. Kompetencat e dhëna Bordit përmes shkronjës “dh” të nenit 4 të aktit normativ nr. 7/2022, janë në përputhje me qëllimin dhe objektin e rregullimeve të këtij akti, pavarësisht se kjo dispozitë nuk shtron në mënyrë të detajuar çdo rregullim specifik. Ndërhyrja me ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022 është bërë për një interes publik, konkretisht mbrojtjen e konsumatorit shqiptar nga kufizimet në furnizimin me produkte, si dhe nga rritja e pakontrolluar e çmimeve të tyre, si rrjedhojë e luftës Rusi–Ukrainë. Masat e ndërmarra janë proporcionale, për sa i përket mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe nuk prekin thelbin e së drejtës. Kuadri ligjor në fuqi nuk ishte i mjaftueshëm për mbajtjen nën kontroll të çmimit të importimit dhe prodhimit të produkteve ushqimore.

9.3 Iniciativa ligjore e ndërmarrë nuk cenon *parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*. Ligji nuk i ka dhënë Bordit ose Këshillit të Ministrave kompetencën për të aplikuar çmime me kriterë diferencuese dhe Bordi nuk ka tagër të vlerësojë

gjendjen ekonomike të secilit operator, në funksion të përcaktimit të çmimit, për sa kohë që ai është produkt i një analize gjithëpërfshirëse të disa elementëve të reflektuar në metodologjinë e çmimit. Për më tepër, ligji vendos detyrime me karakter të përgjithshëm, impakti i të cilave matet përmes indikatorëve të lidhur me interesin publik në tërësi dhe nuk mund të reflektojë interesa specifike individuale.

9.4 Aktet e kundërshtuara nuk shkelin rregullat e MSA-së për konkurrencën. Në rastin konkret nuk ekziston një marrëveshje mes ndërmarrjeve ose sipërmarrësve, pasi ndërhyrja në kontrollin e çmimeve në treg është bërë nga strukturat shtetërore për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me çmimet që mund të vendosin kompanitë importuese të produkteve ushqimore. Pjesëmarrja në Bord e shoqërive të biznesit dhe grupeve të interesit i shërben objektivitetit të vendimmarrjes dhe transparencës. Për më tepër, ato nuk kanë peshë kryesore në vendimmarrje. Nxjerrja e akteve të kundërshtuara është bërë në kushtet e nevojës dhe urgjencës, situatë kjo përjashtimore e parashikuar në nenin XXI, shkronja “b”, nënparagrafi “iii”, të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë 1994 (GATT). Situata emergjente e krijuar ka ndikuar edhe në degë të tjera të tregtisë, duke e shtyrë Këshillin e Bashkimit Evropian në miratimin e rregullores (BE) 2022/1854, datë 6.10.2022. Për dy aktet normative të miratuara nga Kuvendi, Shqipëria ka njoftuar Sekretariatit e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe Komitetin e Aksesit në Treg.

9.5 Pretendimet e kërkuesit që kanë të bëjnë me mosrespektimin e nenit 68, pika 2, të rregullores së Kuvendit, në procedurat parlamentare për hartimin e relacioneve shoqëruese të projektligjeve, nuk gjejnë mbështetje në Kushtetutë dhe në jurisprudencën kushtetuese. Si në aspektin formal, ashtu edhe në atë procedural, aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 janë hartuar dhe miratuar në përputhje me procedurat parlamentare, legjislationin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare. Kërkuesi nuk ka paraqitur fakte dhe argumente të nivelit kushtetues dhe pretendimet e tij për miratimin e ligjeve respektive nuk janë të karakterit procedural kushtetues, por të karakterit procedural të parashikuar nga rregullorja e Kuvendit. Për



rrjedhojë, nuk përbëjnë shkak për të deklaruar antikushtetutshmërinë e ligjit.

10. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka paraqitur të njëjtat parashtrime ashtu si edhe Kuvendi.

11. **Subjekti i interesuar, Autoriteti i Konkurrencës**, nuk ka mbajtur qëndrim për objektin e kërkesës. Ai ka parashtruar se nuk ka bërë vlerësim “*ex ante*” dhe “*ex post*” të akteve normative objekt gjykimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin

12. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Ajo është analizuar nga Gjykata në drejtim të legjitimit *ratione personae*, *ratione temporis* dhe *ratione materiae*. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i analizojë këto kritere edhe në rastin konkret.

A.1. Për legjitimimin *ratione personae*

13. Në lidhje me legjitimimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve për inicimin e kontrollit abstrakt të normës ligjore, në mënyrë të vazhdueshme Gjykata ka vlerësuar se në zbatim të nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si: konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar. Në këtë kuptim, ky subjekt ka të drejtë të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 55, datë 27.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi, një grup prej 29 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, përfaqëson një subjekt të pakushtëzuar, i cili nuk ka nevojë të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë në lidhje me çështjen në shqyrtim, për shkak të interesit publik që mbart dhe, si i tillë, legjitimohet *ratione personae* të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve normative të kundërshtuara.

A.2 Për legjitimimin *ratione temporis*

15. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, bazuar në përmbajtjen e nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën është 2 vjet nga hyrja në fuqi e aktit. Aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 kanë hyrë në fuqi menjëherë dhe janë botuar në Fletoret Zyrtare nr. 48, datë 30.3.2022 dhe nr. 72, datë 13.5.2022. Më pas, këto akte normative me fuqinë e ligjit janë miratuar me ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022 të Kuvendit, të cilat janë botuar në Fletoret Zyrtare nr. 76, datë 20.5.2022 dhe nr. 102, datë 8.7.2022. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë dorazi më datë 19.9.2022, për rrjedhojë ajo është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar dhe kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e tyre.

A.3 Për legjitimimin *ratione materiae*

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, të lirisë së veprimtarisë ekonomike, parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe të rregullave të konkurrencës të parashikuara nga MSA-ja dhe TFBE-ja. Sipas tij, aktet normative të kundërshtuara kanë cenuar edhe nenin 68 të rregullores së Kuvendit, për shkak se relacionet bashkëlidhur këtyre projektakteve nuk kanë përmbushur disa prej kritereve të përcaktuara në këtë nen.

17. Gjykata vëren se pavarësisht se objekt i ankimit kushtetues janë ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022, ato kanë të bëjnë, në thelb, me aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022, të miratuara përmes tyre.

18. Në lidhje me kufijtë e juridiksionit kushtetues, ai nuk është vënë në diskutim gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, as në rastin kur Kuvendi ka shprehur vullnetin e tij me ligj miratues, por ky i fundit nuk është bërë objekt kundërshtimi as kur objekt kundërshtimi ka qenë njëkohësisht si akti normativ, ashtu edhe ligji miratues. Gjykata ka vlerësuar se është detyrë dhe pjesë e natyrshme e juridiksionit të saj vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit normativ, si dhe ligjit miratues të Kuvendit. Kontrolli mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të aktit normativ me fuqinë e ligjit shtrihet edhe mbi ligjin miratues, në referim të nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës (*shih vendimet 18, datë 7.7.2022; nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



19. Sipas jurisprudencës kushtetuese, dispozitat e ligjit të konvertimit nuk mund të vlerësohen, në aspektin e kushtetutshmërisë së tyre, në mënyrë të pavarur nga ato të vetë aktit normativ. Për më tepër, fakti që ky i fundit hyn menjëherë në fuqi, bën që akti normativ të sjellë ndryshime edhe të pakthyeshme si në aspektin material, ashtu edhe në rendin juridik dhe, nga ana tjetër, bën të qartë arsyen e dispozitës kushtetuese që i atribuon qeverisë përgjegjësinë e nxjerrjes së dekretligjit, si dhe kushtëzon në kohë aktivitetin e parlamentit, në veçanti ndaj funksionit normal ligjvënës (*shih vendimet nr. 23, datë 16.4.2014; nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, çështja e pajtueshmërisë së aktit normativ me fuqinë e ligjit me Kushtetutën, si dhe e ligjit miratues të tij, substancialisht dhe formalisht përfshihet në kategoritë e çështjeve për të cilat ka të drejtë të vendosë Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 18, datë 7.7.2022; nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkuksi legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, të lirisë së veprimtarisë ekonomike, të parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe të rregullave të konkurrencës të parashikuara nga MSA-ja.

22. Po ashtu, kërkuksi pretendon se relacionet e projektakteve normative nuk kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të nenit 68, pika 2, të rregullores së Kuvendit, konkretisht: ndikimin ekonomik, social e mjedisor, ndjeshmërinë gjinore, shkallën e përmbushjes së objektivave të agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej saj, si dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në organizma dhe akte ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

23. Në respektim të parimit të vetërregullimit të Kuvendit, Gjykata ka vlerësuar se në parim rregullorja e tij nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues nga Gjykata, pasi ajo përbën një akt juridik që ka si qëllim të vendosë rregulla për veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Mosrespektimi i saj e bën veprimtarinë parlamentare antikushtetuese vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë

pasqyrim në të, ndërsa për çështje të tjera rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues (*shih vendimet nr. 1, datë 23.1.2023; nr. 1, datë 16.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se Kuvendi është organi që me rregullore interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. Në rastet kur Kuvendi ka bërë vetë interpretim të normave të rregullores së tij dhe kur këto norma nuk janë të parashikuara drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por u takojnë interpretimeve e diskrecionit të atij organi, Gjykata nuk mund të arrijë në konkluzione të ndryshme (*shih vendimet nr. 1, datë 16.2.2022; nr. 44, datë 7.10.2011; nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata konstaton se pretendimi për mangësitë e relacioneve të projektakteve normative, sipas kërkesave të nenit 68 të rregullores së Kuvendit, nuk ka të bëjë me ekzistencën e veseve formale të ligjeve miratuese të tyre, në kuptim të neneve 81 dhe 82 të Kushtetutës, por me procedurën e hartimit të relacioneve të projektakteve. Pretendimet e parashtruara në këtë drejtim nuk rezultojnë të jenë të natyrës kushtetuese, të tilla që t'i nënshtrohen juridiksionit të saj, pasi kanë të bëjnë me aspekte të rregullimit të veprimtarisë parlamentare që nuk gjejnë mbështetje në nene konkrete të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuksit nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.¹

25. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se në kushtet kur Republika e Shqipërisë nuk i ka përmbysur ende procedurat për integrimin në Bashkimin Evropian, edhe pretendimet e kërkuksit se aktet e kundërshtuara cenojnë TFBE-në qëndrojnë jashtë

¹ Anëtarët Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja votuan për legjitimitimin *ratione personae* të kërkuksit dhe për këtë pretendim, me arsyetimin se Gjykata vlerëson edhe procedurën për miratimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000. Pretendimet e kërkuksit për plotësimin formal të akteve parlamentare sipas rregullores së Kuvendit, në rastin konkret, lidhen jo vetëm me detyrimin kushtetues të Kuvendit për të kontrolluar kushtet e nevojës, urgjencës dhe përkohshmërisë së masave të aktit normativ, sipas nenit 101 të Kushtetutës, por edhe me respektimin e parimit të lirisë ekonomike dhe të konkurrencës, që përbën angazhim ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.



juridiksionit të saj, pasi ky akt nuk është pjesë e rendit juridik shqiptar. Këtë qëndrim Gjykata e ka mbajtur edhe në çështje të tjera, ku janë ngritur pretendime të ngjashme (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Përveç sa më lart, në lidhje me pretendimet e kërkuarit për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, për shkak të mungesës së analizës së kushteve kushtetuese të nevojës dhe urgjencës në nxjerrjen e akteve të kundërshtuara; për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike; për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit; për mosrespektimin e rregullave të konkurrencës të garantuara nga MSA-ja, Gjykata vlerëson se edhe pse këto pretendime lidhen me aktin normativ nr. 7/2022, Gjykata do të kontrollojë edhe aktin normativ nr. 9/2022, përmes të cilit janë bërë shtesa në përmbajtjen e nenit 8, pika 2, të aktit normativ nr. 7/2022, në lidhje me mbajtjen e rezervave me qëllim përballimin e situatës, si dhe garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë, pasi akti në fjalë nuk mund të qëndrojë pa aktin normativ nr. 7/2022.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës

27. Kërkuarisi ka pretenduar se aktet normative janë miratuar nga Këshilli i Ministrave pa një analizë të fakteve dhe rrethanave konkrete, si dhe nëse janë përmbushur kushtet kumulative të kësaj dispozite kushtetuese, konkretisht nevoja dhe urgjenca. Sipas tij, Këshilli i Ministrave është mjaftuar me një formulim të përgjithshëm, ndërkohë që kishte në dorë mekanizma të tjerë ligjorë dhe institucionalë për garantimin e mbrojtjes së konsumatorit. Qeveria nuk ndërmori hapa për disiplinimin e shoqërive të tregtimit me shumicë ose pakicë të lëndëve ushqimore gjatë pandemisë COVID-19, pavarësisht rritjes së produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to. Konfliktet dhe tensionet ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës, si dhe roli i tyre në tregun ushqimor nuk përbëjnë situatë krejtësisht të paparashikuar, çka nuk justifikon urgjencën me të cilën janë nxjerrë aktet konkrete. Qeveria kishte mundësi të paraqiste në Kuvend projektligj për shqyrtim me procedurë të përsheptuar, por ka preferuar nxjerrjen e akteve ligjore me fuqinë e ligjit, çka është shndërruar në rregull në praktikën qeverisëse 2013–2022. Nën frymën dhe germën e Kushtetutës

akte të tilla duhet të nxirren vetëm në situata të veçanta.

28. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë prapësuar se aktet normative janë nxjerrë në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës. Situata emergjente për produktet ushqimore në tregun shqiptar, si rrjedhojë e situatës në tregun ndërkombëtar, ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen për rregullimin e saj. Krijimi i Bordit u bë duke pasur parasysh efektet e ardhshme afatmesme që do të kishte fillimi i luftës Rusi–Ukrainë mbi tregjet, mbylljen e tyre në lindje të Evropës, kërkesë-ofertën e ushqimeve, kontratat e furnizimeve të lidhura dhe ato të ardhshme, çmimet e tregtimit dhe luhatjet e tyre, rritjen e çmimeve në vendet evropiane, si dhe ekzistencën e rrezikut të rritjes së pakontrolluar të çmimeve të produkteve kryesore ushqimore, çka mund të kishte edhe natyrë spekulative për shkak të kufizimit të ofertës për këto mallra. Situata emergjente e krijuar nga agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës dhe bashkimi i Shqipërisë me partnerët ndërkombëtarë në kufizimet e vendosura ndaj Rusisë përhapën panik në popullatë, duke rrezikuar edhe sigurinë kombëtare. Deri më sot çmimi i këtyre produkteve është mbajtur në kontroll dhe janë eliminuar spekulimet në treg, çka tregon se aktet kanë sjellë efektet e dëshiruara, duke u respektuar çmimi tavan për shitjen e produkteve ushqimore të përcaktuara nga Bordi, në transparencë të plotë. Po ashtu nga të dhënat e vëna në dispozicion në seancë gjyqësore, gjatë periudhës 2020-2023 akti normativ me fuqinë e ligjit është përdorur 94 herë nga Këshilli i Ministrave si mjet për rregullimin e situatave të krijuara në vend.

29. Neni 101 i Kushtetutës parashikon se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se dhënia e pushtetit ligjvënës qeverisë ka karakter përjashtimor ndaj pushtetit të Parlamentit për të miratuar dispozita ligjore, megjithatë ky përjashtim justifikohet nisur nga fakti se në disa situata, ose



për disa fusha të veçanta, ushtrimi normal i pushtetit ligjvënës kërkon një kohë të caktuar teknike ose, duke konsideruar kompleksitetin e disiplinës në disa sektorë të caktuar, ndërhyrja e ligjvënësit mund të bëhet në një moment të dytë. Përdorimi i këtij instrumenti ligjvënës mbetet në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, por çmohet se përdorimi i tij gjerësisht dhe jo në kushtet e parashikuara nga Kushtetuta, do të cenonte pavarësinë e pushtetit legjislativ dhe karakterin demokratik të shtetit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014; nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. E drejta e pushtetit ekzekutiv për të ushtruar autoritet me anë të akteve normative me fuqinë e ligjit duhet të justifikohet në çdo rast me pranimin e rrethanave të veçanta që e bëjnë të nevojshëm miratimin e rregullimit urgjent (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Nevoja dhe urgjenca janë kushte me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe si të tilla, përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (*shih vendimet nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Kushti *urgjencë* nuk mund të ekzistojë në vetvete pa *nevojën*, sepse *urgjenca* tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa *nevoja* tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Prania e domosdoshme e të dy kushteve rezulton edhe nga analiza gjuhësore e tekstit të nenit 101 të Kushtetutës. Lidhëza “dhe”, si në çdo rast, kërkon pranimin e njëkohshme të të dy kushteve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore janë përdorur lidhëset “ose”/“apo”. Kuptimin e tyre të vërtetë termit *nevojë* dhe *urgjencë* e manifestojnë në kuadër të situatës të rastit

konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Nëse ekziston nevoja për nxjerrjen e një ligji, por pa ndonjë urgjencë të dukshme, qeveria nuk mund të ndërmarrë nismën për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, pasi kjo do të përbënte detyrë të pushtetit legjislativ. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi legjislativ, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, iniciativa ligjvënëse mund t'i kalojë qeverisë. Nëse nuk do të vlerësohej ky aspekt, qeveria do të merrte, pa të drejtë, funksionet ligjvënëse të Kuvendit. (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Situatat e nevojës dhe urgjencës, të cilat përcaktojnë legjitimitetin kushtetues të këtyre akteve qeveritare, duhet të jenë faktike, objektive, të përcaktueshme dhe të pavarura nga vullneti i Qeverisë, i cili, në të tilla rrethana, kushtëzohet nga nevoja e reagimit të menjëhershëm, me qëllim mbrojtjen e interesit publik (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës, vlerësimin e parë faktik dhe substancial të kushteve të nevojës dhe urgjencës i përket ta bëjë Këshilli i Ministrave, si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për vlerësimin e situatave që kërkojnë ndërhyrje dhe rregullime të menjëhershme. Ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ me fuqinë e ligjit dhe qeveria është e detyruar të shpjegojë dhe argumentojë përmbushjen e këtyre kushteve (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Nga ana tjetër, Kuvendi i Shqipërisë është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Duke përdorur termin “miraton”, dokumenti themelor i shtetit ka parasysh vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe shprehjen e mendimit përfundimtar nga organi vlerësues lidhur me aktin që shqyrton. Natyra e këtij vlerësimi është juridike, por edhe politike. Kuvendi shpreh qëndrimin e tij politik ndaj veprimit ligjvënës të qeverisë, por në të njëjtën kohë, si një organ i ngarkuar për miratimin e ligjeve, kontrollon dhe kushtetutshmërinë e akteve



normative të nxjerra dhe përputhjen e tyre me dispozitat e tjera ligjore. Vlerësimi dhe kontrolli i Kuvendit mbi aktin normativ me fuqinë e ligjit bazohet në faktin se pushteti ekzekutiv, në këtë rast, ushtron përjashtimisht një funksion ligjvënës (*shih vendimet nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Përpara miratimit ose mosmiratimit të normës së nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi e shqyrton atë për ta vlerësuar si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Ai shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Kompetenca që i është njohur pushtetit ligjvënës për vlerësimin përfundimtar të akteve të tilla, përpara miratimit të tyre, nuk përjashton juridiksionin e Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, në kuptim të nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse Qeveria ka një hapësirë të gjerë diskrecioni, nevoja dhe urgjenca janë koncepte që nuk janë imune nga kontrolli kushtetues në kontekstin e kufizimeve të vendosura nga Kushtetuta. Arsytet “teorike dhe abstrakte” dhe urgjenca “subjektive” nuk mund të justifikojnë përdorimin nga qeveria të institutit të akteve normative me fuqinë e ligjit dhe nuk justifikojnë një situatë të jashtëzakonshme dhe urgjente nevojë (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Nisur nga natyra përjashtimore e kompetencës së Këshillit të Ministrave në nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, në respekt të hierarkisë së burimeve të së drejtës, të kërkesave që burojnë nga parimi i ndarjes dhe balancimit midis pushteteve dhe vlerave mbi të cilat bazohet shteti i së drejtës, para së gjithash, kufijtë e diskrecionalitetit që ka Qeveria, në vlerësimin e situatës së jashtëzakonshme dhe të nevojës urgjente, përcaktohen dhe u nënshtrohen kërkesave kushtetuese dhe kufizimeve përkatëse. Mosrespektimi nga Këshilli i Ministrave i kriterëve dhe kufizimeve kushtetuese procedurale dhe lëndore përbën një të metë të legjitimitetit kushtetues të qeverisë për nxjerrjen e aktit normativ dhe, po ashtu, një të metë të ligjit që ka

miratuar Kuvendi (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese italiane (*shih vendimet nr. 270/1996; nr. 171/2007; nr. 128/2008; nr. 22/2012; nr. 34/2013 të Gjykatës Kushtetuese italiane*), ka theksuar se përdorimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit (dekretiligjit) dhe, për rrjedhojë, marrja e përgjegjësisë nga ana e pushtetit ekzekutiv, nuk mund të mbështetet thjesht në përmendjen e ekzistencës së kushteve të urgjencës dhe nevojës, si dhe nuk mund të justifikohet në konstatimin e arsyeshmërisë së disiplinës së re. Gjithsesi, ajo ka vlerësuar se në kontrollin kushtetues duhet të rezultojë në mënyrë të qartë mungesa e kushteve paraprake për nxjerrjen e akteve normative me fuqinë e ligjit. Ekzistenca paraprake e një situatë faktike që passjell nevojën dhe urgjencën për përdorimin e një instrumenti të jashtëzakonshëm, siç është akti normativ me fuqinë e ligjit, përbën një kërkesë kushtetuese për miratimin e këtij akti, në kuptimin që, në rast se këto parakushte haptazi ose dukshëm mungojnë, ato përcaktojnë një të metë të aspektit kushtetues të aktit normativ me fuqinë e ligjit. Shqyrtimi i rasteve kur haptazi/dukshëm mungojnë kushtet e vendimarrjes me urgjencë, bazohet në një *test* të përbërë nga një sërë elementesh që përfshijnë preambulën e aktit normativ me fuqinë e ligjit, relacionin shpjegues të tij dhe raportet parlamentare të projektligjit miratues, si dhe kontekstin normativ në të cilin “përfshihet” akti normativ me fuqinë e ligjit (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Nga sa më lart, Gjykata rithekson se neni 101 i Kushtetutës parashikon kushte të natyrës materiale, konkretisht nevojën dhe urgjencën, si dhe të natyrës procedurale, konkretisht miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit brenda 45 ditëve nga Kuvendi, pasi në të kundërt akti humbet fuqinë e tij që nga fillimi. Në drejtim të plotësimit të këtyre kushteve në rastin konkret, Gjykata vlerëson të analizojë nëse në miratimin e akteve normative të kundërshtuara Këshilli i Ministrave ka respektuar kushtet kushtetuese të “nevojës” dhe “urgjencës”, si pretendime thelbësore të kërkuar.

40. Duke iu referuar përmbajtjes së relacionit shoqërues të aktit normativ nr. 7/2022, Gjykata vëren se Këshilli i Ministrave ka justifikuar nevojën për nxjerrjen e akteve me situatën urgjente të krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të



produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar, ardhur si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar, çka, sipas tij, ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen dhe rregullimin e kësaj situate me akt normativ, përmes të cilit është synuar përcaktimi i masave të veçanta që do të merren ndaj subjekteve publike ose private, vendase ose të huaja, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre importimin dhe prodhimin e produkteve ushqimore bazë gjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së veçantë në tregun shqiptar, të ndikuar nga situatat në tregun ndërkombëtar (*shih relacionin për projektaktin normativ nr. 7/2022, faqet 1-2, pika III*). Ndërsa, sipas përmbajtjes së relacionit të aktit normativ nr. 9/2022, Këshilli i Ministrave ka argumentuar se situata urgjente është krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar, ardhur si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar dhe lufta në Ukrainë. Kjo situatë ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen dhe rregullimin e saj me akte rregullatore, për pasojë me aktin normativ nr. 7/2022 janë miratur rregulla të posaçme për përballimin e situatës. Në pikën 2 të nenit 8 të aktit normativ nr. 7/2022 është përcaktuar se të gjitha subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, të nevojshme për furnizimin e popullatës, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg (*shih relacionin për projektaktin normativ nr. 9/2022, faqet 1 dhe 2, pika III*). Në këto kushte, sipas Këshillit të Ministrave, aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 kanë përmbushur kriteret e nevojës dhe urgjencës të parashikuara në nenin 101 të Kushtetutës (*shih relacionin për projektaktin normativ nr. 7/2022, faqe 4, pika IV dhe relacionin për projektaktin normativ nr. 9/2022, faqe 2, pika IV*).

41. Po kështu, sipas shpjegimeve në seancë plenare dhe provave të depozituara gjatë seancës, Këshilli i Ministrave ka parashtruar se situata e veçantë e krijuar nga lufta Rusi–Ukrainë ka sjellë pasojë në zinxhirin dhe kanalet e furnizimeve për produktet kryesore jetike të konsumit, si për shkak të importit të shumicës së këtyre mallrave nga vendet në konflikt, ashtu edhe për shkak të

ruajtjes së rezervave edhe nga vendet e tjera, përmes ndalimit të eksportit të tyre. Kontratat e furnizimit të operatorëve kryesorë të vendit në importimin e produkteve ushqimore bazë ishin lidhur me kompani nga ky rajon. Në këto kushte, monitorimi i çmimeve të disa produkteve ushqimore bazë përbënte një masë në ndihmë të konsumatorit, me qëllim shmangien e mungesës së mallrave në treg, abuzimit me çmimet për këto produkte, inflacionit, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve, si dhe lehtësimin e kostos së jetesës (*shih shkruesin nr. 499/2 prot., datë 2.2.2023 të Kryeministrit, faqja 2*).

42. Gjatë vlerësimit të aktit normativ nr. 7/2022, Gjykata vëren se ai i është nënshtruar diskutimeve në tri komisione të Kuvendit: Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin; Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Gjykata konstaton se Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se akti i paraqitur ishte në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, dhe se në aspektin procedural ishte paraqitur në përputhje me rregulloren e Kuvendit (*shih raportin e datës 19.4.2022 të Komisionit të Kuvendit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, faqja 3, paragrafi i fundit*). Po kështu, edhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka vlerësuar se në aspektin ligjor akti normativ ishte në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi dhe se në aspektin procedural ishte në përputhje me rregulloren e Kuvendit (*shih raportin e datës 19.4.2022 të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, faqja 4*). Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, pasi ka analizuar argumentet e qeverisë se rritja e çmimeve në vend ka ardhur si pasojë e rritjes së çmimeve të bursës për miellin e grurin, si dhe e rritjes së kostos së transportit të këtyre produkteve, çka ka çuar në rritjen e inflacionit në vend, si dhe pasi është njohur me raportet e dy komisioneve të tjera për aktin normativ nr. 7/2022, në aspektin ligjor e ka vlerësuar atë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural në përputhje me rregulloren e Kuvendit (*shih raportin e datës*



19.4.2022 të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, faqet 2, 5 dhe 6).

43. Nga sa më lart, Gjykata nuk vë në diskutim impaktin e luftës Rusi–Ukrainë, pasi jo vetëm në Shqipëri, por edhe në një sërë shtetesh të tjera, si: Kosovë, Maqedoni e Veriut, Çeki, Sllovaki, Moldavi, Litواني, Holandë, Azerbajxhan etj. janë ndërmarrë masa konkrete, sipas hapësirës së vlerësimit të shtetit, për rregullimin e situatave të krijuara në vendet respektive. Megjithatë, në rastin konkret, Gjykata evidenton se relacionet shoqëruese të akteve normative të kundërshtuara nuk përmbajnë një vlerësim të ndikimit konkret në tregun kombëtar dhe konsumatorin shqiptar nga situata e krijuar në tregun ndërkombëtar dhe të efekteve të luftës Rusi–Ukrainë në këtë situatë, madje në relacionin e aktit normativ nr. 7/2022, lufta në Ukrainë as nuk përmendet si shkak urgjence. Pavarësisht se në Komisionin për Ekonominë dhe Financat janë parashtruar disa argumente në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se ato janë të pamjaftueshme për të kuptuar ndikimin e situatës së krijuar në tregun kombëtar, si rrjedhojë e situatës në tregun ndërkombëtar, në drejtim të analizës së çmimeve të tregut para dhe pas fillimit të luftës. Po ashtu, edhe pse një vlerësim i tillë është paraqitur nga Këshilli i Ministrave në seancë plenare para Gjykatës, përmes shkresës nr. 499/2, datë 2.2.2023 të Kryeministrit, Gjykata rithekson rëndësinë e analizës paraprake të kushteve të nevojës dhe urgjencës, në mënyrë që të mund të kuptohet se ato kanë ekzistuar në kohën e marrjes së nismës për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kohën e kontrollit të këtyre kritereve nga Kuvendi. Po kështu, analiza e këtyre kushteve duhet të gjejë vend, në mënyrë të arsyetuar, edhe në raportet përkatëse të ligjeve të Kuvendit për miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit.

44. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se në drejtim të përmbushjes së kritereve të përcaktuara nga neni 101 i Kushtetutës për nxjerrjen e akteve normative të kundërshtuara, Këshilli i Ministrave, në cilësinë e organit që ka i nxjerrë ato, dhe Kuvendi, në cilësinë e organit që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës në nxjerrjen e tyre, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim. Po në këtë drejtim, nga tërësia e

materialeve dhe provave të paraqitura nga palët, Gjykata konstaton se në lidhje me kushtet kushtetuese të nevojës dhe urgjencës, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk kanë kryer një analizë të situatës konkrete, e cila do të justifikonte nevojën për ndërhyrje urgjente nëpërmjet akteve normative me fuqinë e ligjit. Po kështu, ata nuk kanë dhënë asnjë arsye se pse instrumentet ligjore dhe institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për realizimin e qëllimit që kërkohet të arrihet për mbrojtjen e konsumatorit nga praktikat abuzive, dhe në përmbajtje të akteve e dokumenteve shoqëruese nuk rezultojnë argumente mbi arsyet e shkaqet që do të justifikonin përdorimin e këtij mjeti për arritjen e menjëhershme të rezultatit në treg.

45. Gjykata thekson se raste nevojë dhe urgjence, të krijuara në vend, mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme nga Këshilli i Ministrave, përmes miratimit të akteve normative me fuqinë e ligjit, megjithatë argumentet se pse rasti paraqet nevojë dhe urgjencë dhe pse nuk mund të procedohet përmes miratimit të ligjeve me procedurë normale ose të përshpejtuar, duhet të gjejnë vend në relacionet përkatëse. Ky standard është i domosdoshëm në vlerësimin e Gjykatës, pasi është tregues i matshëm i kontrollit efektiv të pushtetit ligjvënës ndaj ekzekutivit dhe i kontrollit të mëvonshëm të Gjykatës ndaj akteve të këtyre pushteteve. Akti normativ me fuqinë e ligjit sjell efekte të menjëhershme që në momentin e miratimit, megjithatë vetëm ky fakt nuk mund të justifikojë përdorimin e këtij instrumenti kushtetues me karakter përjashtimor për rregullimin e çdo situatë ligjore, duke pasur parasysh se disa situata mund të rregullohen edhe me nismë ligjore nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, si dhe me procedurë të përshpejtuar, sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës.

46. Për sa më sipër, edhe pse në situata të veçanta Gjykata pranon se Këshilli i Ministrave mund të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit, në kushtet kur kjo ndërhyrje realizohet, ajo duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga neni 101 i Kushtetutës, të cilat duhet të gjejnë vend dhe të analizohen si në relacionet që shoqërojnë aktin normativ, ashtu edhe në dokumentet që shoqërojnë miratimin e ligjeve



ratifikuese, në mënyrë që të mund të realizohet edhe kontrolli kushtetues mbi ekzistencën e tyre. Nëse një analizë e tillë mungon, kërkesat e parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës nuk mund të konsiderohen si të përmbushura.

47. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 nuk provohet të jenë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe urgjencës dhe, për rrjedhojë, këto akte dhe ligjet miratuese të tyre nuk janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës.

48. Në kushtet kur Gjykata arriti në përfundimin se aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 janë miratuar në mungesë të nevojës dhe urgjencës, si kritere të përcaktuara nga neni 101 të Kushtetutës, ajo vlerëson të mos ndalet në analizën e pretendimeve të tjera të kërkuarit.

49. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa, sipas arsyetimit të mësipërm, është e bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e ligjit nr. 41/2022, datë 21.4.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, ‘Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg’”, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Shfuqizimin e ligjit nr. 51/2022, datë 9.6.2022, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 11.5.2022 ‘Për një shtesë në aktin normativ nr. 7, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave ‘Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte

ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg’”, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 22.2.2023.

Shpallur, më 23.3.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj (pjesërisht kundër)

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Genti Ibrahim

Anëtar kundër: Sandër Beci

Anëtare pjesërisht kundër: Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 5 (NJ) 2022 me kërkesë jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin, si të papajtuashme me Kushtetutën, të ligjeve nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022, Gjykata ka vendosur pranimin tërësisht të kërkesës dhe shfuqizimin e akteve të kundërshtuara, pasi ka arritur në përfundimin se nuk provohet që ato të jenë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, për rrjedhojë, nuk janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës (*shih paragrafin 47 të vendimit*).

2. Në ndryshim nga sa më sipër, jam e qëndrimit që Gjykata nuk duhej të kishte shfuqizuar tërësisht aktet e kundërshtuara, pasi duhej të kishte vlerësuar se aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 janë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe urgjencës, për rrjedhojë, në vlerësimin tim, ato janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës. Pavarësisht këtij qëndrimi, vlerësoj se në rastin konkret duhej të ishte vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës, duke u shfuqizuar vetëm nenet 3, pika 2 dhe 10, pika 2, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022, të ndryshuar. Duke qenë se shkaqet ku mbështes qëndrimin tim janë të ndryshme nga ato për të cilat Gjykata ka vendosur pranimin tërësisht të kësaj kërkesë, vlerësoj t'i parashtoj dhe argumentoj në këtë mendim si gjyqtare në pakicë.

3. *Së pari*, qëndrimi im ndahet tërësisht nga ai i shumicës në lidhje me pretendim kryesor të



parashtruar nga kërkuesi, ai për respektimin e kritereve kushtetuese për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 101 të Kushtetutës. Në vlerësimin tim, në këtë gjykim u arrit të provohej se aktet normative të kundërshtuara janë miratuar në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, si dhe në përputhje me interpretimin që vetë jurisprudenca kushtetuese i ka bërë normës kushtetuese. Në vijim, fillimisht vlerësoj të analizoj qëllimin e normës kushtetuese (*neni 101 i Kushtetutës*).

4. Çmoj se në analizën e nenit 101 të Kushtetutës dallohet qartë se konkurrojnë pesë koncepte kryesore: (i) “*Nevoja*”, që i referohet një situatë vështirësie të veçantë që nuk mund të mënjanohet me mjetet dhe masat ekzistuese. Ajo lidhet me një domosdoshmëri të shkallës së lartë për nxjerrjen e një akti me fuqinë e ligjit dhe me faktin që nuk i lë qeverisë mundësi zgjedhjeje tjetër. Në rast nevoje lista e mundësive është e limituar dhe për emergjencë zgjidhet njëra që vlerësohet nga qeveria me pasoja më pak rënduese. Ndonëse relacioni shoqërues i aktit normativ me fuqinë e ligjit ka analizuar në mënyrë sipërfaqësore nevojën për nxjerrjen dhe miratimin e ligjit, përsëri kjo nuk dëshmon se kjo nevojë nuk ekzistonte. (ii) “*Urgjenca*” për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit lidhet me faktin se shpejtësia dhe elementi kohë janë vendimtare në realizimin e qëllimit të nxjerrjes së aktit, sepse duhet të jetë një tërësi masash në kundërveprim ndaj gjendjes së krijuar në treg për shkak të pandemisë dhe luftës në Ukrainë. (iii) “*Përgjegjësia e Këshillit të Ministrave*” dëshmon se veprimi në kushtet e nevojës dhe të urgjencës mund të shoqërohet në një mënyrë të natyrshme me një masë risku të arsyeshme dhe pikërisht për këtë arsye kushtetutëbërësi ia ngarkon përgjegjësinë e pasojave të një akti normativ të tillë vetë Këshillit të Ministrave si organ kushtetues dhe jo një organi tjetër. (iv) Parashikimi i veprimit të aktit normativ në kohë si një akt që sanksionon nxjerrjen e “*Masave të përkohshme*” dëshmon se mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, masa e marrë përmes aktit normativ me fuqinë e ligjit është e përkohshme, sepse akti normativ me fuqinë e ligjit vepron për një periudhë kohore maksimalisht 45 ditore, derisa miratohet dhe kthehet në ligj nga Kuvendi. (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). (v) “*Afat i shpejtë i miratimit*” me parashikimin se brenda 5 ditëve mbledhet Kuvendi

për të miratuar aktin normativ me fuqinë e ligjit tregon edhe njëherë që urgjenca shprehet me veprime e masa të shpejta dhe emergjente. Procedura e miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit është më e shpejta krahasuar me afatin e miratimit të një ligji me procedurë të përsheptuar, për të cilin kërkohen ligjërisht afate më të gjata, që faktikisht shkojnë të paktën në kufirin e dy muajve nga momenti i rrugëtimit të iniciativës ligjvënëse. Nga këto koncepte ligjore të parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës, “*nevoja*” dhe “*urgjenca*” kanë natyrën e kushteve kumulative, të cilat diktojnë në mënyrë prioritare pajtueshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit me Kushtetutën.

5. Në rastin konkret, duke analizuar kontekstin kohor dhe faktik të nxjerrjes së aktit normativ, si dhe gjendjen reale të tregut shqiptar, vërehet se lufta në Ukrainë që pasoi në mënyrë të njëpasnjëshme pandeminë e COVID-19, janë dy forca madhore, pasojat e të cilave u përcollën nga tregu ndërkombëtar në tregun kombëtar në formën e: pasigurisë dhe frikës për mungesa produkte në treg; rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore; pamundësisë së konsumatorëve për t’i blerë ato. Nevoja paraqitet në formën e domosdoshmërisë për të marrë masa për të kontrolluar rritjen e çmimeve, të produkteve ushqimore që përbëjnë një nevojë jetike për çdo familje dhe individ. Urgjenca paraqitet në formën e marrjes së masave të shpejta, emergjente për të frenuar rëndimin e situatës ekonomike në treg. Nevoja dhe urgjenca janë dy kushtet kryesore të parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës, që duhet të konkurrojnë në mënyrë kumulative para nxjerrjes së çdo akti normativ me fuqinë e ligjit, dhe që kanë konkurruar në rastin konkret.

6. Në vijim, vlerësoj të evidentoj parimet kryesore nga të cilat duhet të udhëhiqet, në rastet që bien nën veprimin e nenit 101 të Kushtetutës, veprimtaria e pushtetit ekzekutiv dhe më pas ajo e pushtetit legjislativ. Delegimi i kompetencës së ligjbërjes pushtetit ekzekutiv vetëm për raste përjashtimore, të justifikuara me ekzistencën e njëkohshme të nevojës dhe urgjencës, nga ana tjetër, përfshin edhe kompetencën e organit legjislativ, Kuvendit, për të kontrolluar në mënyrë përfundimtare nëse akti i miratuar në ushtrim të këtij delegimi justifikohet me praninë e rrethanave të veçanta. Gjykata ka vlerësuar se nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në



përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (*shih vendimet nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Elementi *urgjencë* nuk mund të ekzistojë në vetvete pa *nevojën*, sepse *urgjencia* tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa *nevoja* tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Kuptimin e tyre të vërtetë termat *nevojë* dhe *urgjencë* e manifestojnë në kuadër të situatës së rastit konkret, duke u vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre (*shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Kërkuesi ka pretenduar se Këshilli i Ministrave ka abuzuar me përdorimin e kompetencës së parashikuar nga neni 101 i Kushtetutës, duke nxjerrë 112 akte normative me fuqinë e ligjit në periudhën 1.10.2013 deri më 23.5.2022, ndërkohë kur kjo procedurë ligjvënese e jashtëzakonshme duhet të konsiderohet si situatë përjashtimore. Sipas kërkuesit jemi para një “*përdorimi gjerësisht*” të kësaj kompetence, duke cenuar parimin e proporcionalitetit. Rezulton se në vitin 2020 janë miratuar 35 akte normative me fuqinë e ligjit, në vitin 2021 janë miratuar 40 të tillë dhe në vitin 2022 janë miratuar 20 akte normative me fuqinë e ligjit. Nga një analizë e përgjithshme e numrit total të tyre, rezulton se 77 akte normative janë të lidhura drejtpërdrejt me situatën dhe masat e marra për të minimizuar forcën madhore në formën e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, ndërsa 18 të tjerat lidhen me masa indirekte të karakterit fiskal, tatimor, buxhetor etj. që kanë të bëjnë përsëri me situata emergjence.

8. Në rastin konkret, në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave ka bërë vlerësimin e tij në lidhje me ekzistencën e elementeve të nevojës dhe urgjencës që legjitimojnë ndërhyrjen e tij me efekt të menjëhershëm dhe më tej, Kuvendi, si organi kontrollues i verifikimit të plotësimit të këtyre kritereve, ka arritur në përfundimin se situata e rregulluar me aktin normativ ka qenë e tillë që lejonte ndërhyrjen dhe rregullimin e saj në mënyrë të menjëhershme. Pavarësisht diskrecionit që kanë këto dy organe,

sigurisht që vlerësimi që i bën secili prej tyre plotësimit të kritereve të përcaktuara nga neni 101 i Kushtetutës, nuk përjashton kontrollin kushtetues të kësaj veprimtarie dhe akteve që ka prodhuar ajo, duke qenë Gjykata organi i vetëm që vlerëson në mënyrë përfundimtare respektimin e kufijve dhe të diskrecionit që Kushtetuta u ka dhënë këtyre organeve.

9. Në jurisprudencën kushtetuese është sqaruar se nuk është roli i Gjykatës të vlerësojë nëse masat e marra nga autoritetet publike janë të përshtatshmet dhe të duhurat, në aspektin teknik, për përballimin e një situatë të jashtëzakonshme. Në këtë vështrim, interesi publik dikton marrjen e masave kufizuese. Pavarësisht rezervës së mësipërme për aspektin teknik të masave, çështjet e paraqitura për gjykim i japin mundësinë Gjykatës të analizojë, rast pas rasti, rëndësinë e ruajtjes së një interesi publik, si pjesë e qëllimit legjitim që justifikon kufizimet e lirive dhe të drejtave kushtetuese në kushtet e një situatë të diktuar nga forca madhore ose gjendje të jashtëzakonshme (*shih vendimin nr. 11, datë 9.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Prandaj aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2021, të miratuara me ligjet nr. 41/2022 dhe nr. 51/2022, janë marrë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës, për rrjedhojë nuk ka asnjë shkak për shfuqizimin tërësor të tyre, për këtë arsye, për papajftueshmëri me Kushtetutën. Në analizë të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022, neni 2 parashikon termin “situatë e veçantë”, të cilin e lidh me termin “emergjencë”, në kushtet e të cilave ndërmerret tërësia e veprimeve, masave pozitive dhe ndalimeve për të shmangur një rrezik që ose është shfaqur, ose të një rreziku që potencialisht ekzistojnë kushtet të shfaqet në treg në një të ardhme të afërt. Situata e veçantë, në vetvete, nuk është një ngjarje që ka detyrueshmërisht formën dhe përmasat e një force madhore, por është një situatë që vjen si pasojë e veprimt të një force madhore. Situata e veçantë lidhet me një interes publik për mbrojtjen e tregut nga rreziqe që lidhen me ushqimin, si nevojë jetike e çdo qytetari dhe kërkon mundësi teknike për parandalimin e pasojave, të tilla, si ngritja e çmimeve të produkteve ushqimore në treg, sepse në dallim nga vetë forca madhore që është e paevitueshme, situata e veçantë është e evitueshme me masa urgjente dhe parandaluese.



11. Edhe në vlerësimin e shumicës (*shih paragrafin 43 të vendimit*) nuk vihet në diskutim impakti i luftës Rusi–Ukrainë, pasi jo vetëm në Shqipëri, por edhe në një sërë shtetesh të tjera si: Kosova, Maqedonia e Veriut, Çekia, Sllovakia, Moldavia, Lituania, Holanda, Azerbajxhani etj., janë ndërmarrë masa konkrete, sipas hapësirës së tyre të vlerësimit, për rregullimin e situatave të krijuara në vendet respektive. Në vlerësimin tim, kuadri ligjor në fuqi nuk ishte i mjaftueshëm për mbrojtjen e konsumatorit nga praktikatat abuzive të rritjes së çmimeve, gjë që kërkoi ndërhyrjen e shtetit përmes miratimit të akteve konkrete. Situata aktuale ka imponuar këtë rregullim të posaçëm që plotëson si kërkesën e nevojës, ashtu edhe të urgjencës për miratimin e tij.

12. Duke iu referuar përmbajtjes së aktit normativ nr. 7/2022, ai ka për objekt përcaktimin e rregullave për transparencën dhe monitorimin e çmimit të disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg, në zbatim të pikës 3 të nenit 11 dhe të pikës 1 të nenit 17 të Kushtetutës. Kurse në nenin 2 të këtij akti është përcaktuar se cilat janë rastet që përbëjnë situatë të veçantë dhe që lidhen me krijimin prej tyre të situatave emergjente në tregun e disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, sipas listës së përcaktuar nga Bordi. Ashtu siç kanë parashtruar në këtë gjykim subjektet e interesuara, në rastin konkret ka ekzistuar një situatë emergjente, e krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to në tregun shqiptar, si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar. Kjo situatë është e lidhur me gjendjen, pasojat dhe efektet e ardhshme afatmesme që do të kishte fillimi i luftës Rusi–Ukrainë mbi tregjet dhe mbylljet e tyre në lindje të Evropës, kërkesë-ofertës së ushqimeve, kontratat e lidhura të furnizimeve dhe ato të ardhshme, çmimet e tregtimit dhe luhatjet e tyre.

13. Në vlerësimin tim, Këshilli i Ministrave ka justifikuar nevojën për nxjerrjen e akteve normative me fuqinë e ligjit me situatën emergjente të krijuar nga rritja e menjëhershme e çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun ndërkombëtar dhe ndikimit të kësaj situatë në tregun shqiptar. Nevoja lidhet me garantimin e furnizimit të popullatës me produktet më të

domosdoshme ushqimore dhe veçanërisht ruajtjen e çmimeve brenda kufijve normalë të tregtimit, duke ndaluar rritjet spekulative të tyre, në garantim të lirisë ekonomike dhe veprimtarisë së operatorëve ekonomikë, dhe urgjenca lidhet me nevojën për të ndaluar pasojat e pakthyeshme të kësaj situatë. Duke u nisur nga kjo situatë dhe për të parandaluar rrezikun e rritjes së pakontrolluar të çmimeve me pakicë të produkteve ushqimore kryesore, që mund të kishin edhe natyrë spekulative për shkak të kufizimit të ofertës nga jashtë për këto mallra, është parashikuar ngritja e Bordit.

14. Vlerësoj se legjislacioni vendas ekzistues nuk mundësonte marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e tregut dhe të konsumatorit, pasi strukturat ekzistuese të orientuara drejt monitorimit të konkurrencës në treg nuk ishin të dedikuara për kontrollin e tregut për abuzime me çmimin, ose për të shmangur mungesat e produkteve të shportës ushqimore. Kjo e ka shtyrë Këshillin e Ministrave drejt ngritjes së një strukture të re të dedikuar për t'u fokusuar te situata e krijuar në treg, siç është Bordi i Monitorimit të Ushqimeve. Po kështu, rregullat e tregut ndërkombëtar nuk i mundësonin Këshillit të Ministrave kohën e nevojshme për ndjekjen e procedurave ligjvënës të përshpejtuara ose procedurave normale të ligjvënies nga Kuvendi. Në këto kushte, Kuvendi ka miratuar me ligj aktet normative nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 të qeverisë, duke vlerësuar se masat e marra synojnë mbrojtjen e tregut dhe të konsumatorit shqiptar.

15. Gjithashtu, vlerësoj se subjektet e interesuara arritën të përcaktojnë ardhjen e efektit të menjëhershëm të akteve normative të kundërshtuara në raport me efektin që do të sillte miratimi i tyre përmes ligjeve me procedurë të përshpejtuar.

16. Për sa më lart, aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 janë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, për rrjedhojë ato janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës.

17. *Së dyti*, në vijim do të ndalem te kriteret për të cilat vlerësoj si të papajtueshme me Kushtetutën përmbajtjen e neneve 3, pika 2 dhe 10, pika 2, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022.

18. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi anëtarëve të Bordit, përfaqësues të shoqërive të



tregtimit të produkteve ushqimore, u njihet e drejta të marrin vendime për caktimin e çmimeve të shitjes me shumicë dhe pakicë të këtyre produkteve, të paraqesin të dhëna dhe informacione që ndikojnë në vendimmarrje, si dhe të marrin masa disiplinore ndaj konkurrentëve të tyre. Në kushtet e përzgjedhjes së tyre pa kriteret e qarta ligjore, lihen jashtë vendimmarrjes përfaqësues të shoqërive të importit, prodhimit dhe tregtimit të lëndëve ushqimore, që mund të hasin vështirësi dhe shqetësime të shumta në përballimin e situatës.

19. Neni 18 i Kushtetutës është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, ku është theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata shqyrton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se e konstaton këtë fakt, vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim për një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme (*shih vendimet nr. 31, datë 4.10.2021; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas pikës 2 të nenit 3 të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022, Bordi ka në përbërje të tij 7 përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel drejtuesi të lartë dhe 6 përfaqësues të shoqërive të tregtimit të produkteve, ndërsa vendimet merren me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Në vlerësimin tim, pjesëmarrja në këtë Bord e përfaqësuesve të shoqërive të tregtimit të produkteve është një element me rëndësi, sepse

këto subjekte preken drejtpërdrejt nga situata aktuale. Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin për të cilin është miratuar ky akt normativ dhe rolin e kompetencat që ka ky organ (Bordi), vlerësoj se ai nuk siguron një përfaqësim të drejtë të konsumatorëve ose shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve si grupi më i madh i interesit në treg. Për rrjedhojë, grupi më i madh i interesit në treg dhe pala më e pambrojtur, konsumatorët, janë të papërfaqësuar. Edhe pse sipas pikës 3 të këtij neni në mbledhjet e Bordit mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të tjerë nga institucione shtetërore, ekspertë të fushës ose grupe interesi, ky element nuk është i mjaftueshëm për të garantuar një përfaqësim të drejtë të të gjitha subjekteve që preken nga situata që synon të rregullojë ky akt.

21. *Së treti*, lidhur me kushtin e përcaktuar nga neni 101 i Kushtetutës se masat e marra në kushtet e urgjencës dhe nevojës duhet të jenë të përkohshme, vlerësoj se akti normativ nr. 7/2022 nuk ka përcaktuar se sa do të zgjasë tërësia e masave të parashikuara për monitorimin dhe kontrollimin e tregut të ushqimeve dhe as nuk ka parashikuar kushtet kur do të shuhet fuqia e kufizimeve të këtij akti. Mënyra se si ky akt është përpjekur të rregullojë përkohshmërinë vlerësoj se shfaq probleme edhe në drejtim të parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që në nenin 10, pika 2, të tij i ka njohur Bordit kompetencën për të përcaktuar përfundimin e situatës së veçantë, e cila shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 101 i Kushtetutës i referohet Këshillit të Ministrave si institucioni që ka të drejtë të vendosë, nën përgjegjësinë e tij, në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, masa kufizuese të përkohshme dhe, për rrjedhojë, nuk mund t'ia delegojë kompetencat dhe përgjegjësinë e tij një subjekti/organi/institucioni jokushtetues të përkohshëm, siç është Bordi.

22. Gjykata në lidhje me parimin e sigurisë juridike ka vlerësuar se, para së gjithash, ligji duhet kuptuar saktë dhe drejt, prandaj duhet të dalë i qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet, të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se gjatë hartimit të dispozitave



të reja ligjore, ligjvënësi duhet të marrë masat që të eliminohet çdo paqartësi ose papajtueshmëri midis frymës së ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë. Ruajtja e besimit të qytetarëve te shteti dhe te legjislacioni i miratuar prej organeve ligjvënëse të tij, si pjesë e parimit të shtetit të së drejtës, kërkon që autoritetet të mos miratojnë parashikime ligjore të paqarta, të dyfishta, ose që mbivendosen mes tyre (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, parashikimi i kompetencës së Bordit për të vlerësuar dhe përcaktuar me vendim përfundimin e kësaj situate, lë hapësirë për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Përcaktimi i situatës së veçantë, si dhe fillimi dhe përfundimi i saj duhet të lihen në vlerësimin e të njëjtit organ, i cili niset nga të njëjtat premisa faktike dhe analize të situatës. Në rastin konkret, duke vlerësuar kompetencat e Bordit, natyrën e organit dhe qëllimin për të cilin është ngritur ai, ky parashikim shkon përtej hapësirës së vlerësimit dhe çështjeve që ai është ngarkuar të rregullojë dhe përcaktojë.

24. Për sa më sipër, konkludoj se nenet 3, pika 2 dhe 10, pika 2, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 duhet të shfuqizoheshin, pasi bien ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese që lidhen me barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe me parimin e sigurisë juridike.

Anëtare: Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 5 (Nj) 2022 të Regjistrat Themeltar, që i përket kërkuarit, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 41/2022, për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7/2022 dhe ligjit nr. 51/2022, për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9/2022, Gjykata ka vendosur pranimin tërësisht të kërkesës dhe shfuqizimin e akteve të kundërshtuara, duke vlerësuar se ato nuk janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës, pasi nuk është provuar se janë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe të urgjencës.

2. Në ndryshim nga sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se aktet e kundërshtuara janë

miratuar në përputhje me kriteret e nenit 101 të Kushtetutës dhe se gjatë këtij gjykimi rezultoi në mënyrë të qartë se në momentin e miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 nga Këshilli i Ministrave, shtuar me aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2022, ekzistonte një situatë faktike, e përcaktueshme objektivisht dhe e pavarur nga vullneti i qeverisë, e kushtëzuar nga nevoja e reagimit të menjëhershëm për mbrojtjen e interesit publik, që nuk mund të kryhej në mënyrë të shpejtë dhe të arsyeshme nga ligjvënësi as në kushtet e procedurës legjislative të përshpejtuar. Për rrjedhojë, ne arrijmë në përfundimin se pretendimet e kërkuarit për mosrespektimin e nenit 101 të Kushtetutës janë të pabazuara, ndaj duhej të ishin rrëzuar.

3. Megjithatë, ndërsa unë gjyqtari Sandër Beci jam ndalur vetëm në drejtim të plotësisht të kërkesave kushtetuese të nevojës dhe urgjencës për miratimin e aktit normativ nr. 7/2022, shtuar me aktin normativ nr. 9/2022, të cilat do të parashtrihen në vijim dhe për të cilat, si gjyqtarë në pakicë, kemi arritur në një qëndrim të përbashkët, unë gjyqtarja Holta Zaçaj, kam vijuar më tej vlerësimin tim edhe në drejtim të kushtetutshmërisë së aktit normativ nr. 7/2022, duke arritur në përfundimin se përmbajtja e nenit 10, pika 2, të tij është e vesuar nga pikëpamja kushtetuese, pasi nuk plotëson kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

4. Për sa më sipër, fillimisht ne do të parashtrojmë argumentet tona në mbështetje të qëndrimit të përbashkët për pajtueshmërinë e akteve të kundërshtuara me nenin 101 të Kushtetutës.

5. Neni 101 i Kushtetutës parashikon se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme. Në jurisprudencën kushtetuese janë elaboruar tashmë, në mënyrë të qartë e shteruese, konceptet “nevojë” dhe “urgjencë” që përmban norma kushtetuese, të cilat janë evidentuar në mënyrë të plotë edhe në vendimin e shumicës. *Nevoja* dhe *urgjenca* janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë përcaktues për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Situatat e nevojës dhe të urgjencës duhet të jenë faktike, objektive, të përcaktueshme dhe të pavarura nga vullneti i



qeverisë, që kushtëzohen nga nevoja e reagimit të menjëhershëm, me qëllim mbrojtjen e interesit publik (*shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ato janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti dhe mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë, si, fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit, ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, nisma ligjvënëse mund t'i kalojë qeverisë. Nëse nuk do të vlerësohej ky aspekt, qeveria do të merrte, pa të drejtë, funksionet ligjvënëse të Kuvendit (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësojmë se në këtë gjykim u arrit të provohej se rrethanat dhe situatat konkrete faktike, që përfaqësojnë një situatë të pazakontë, për rrjedhojë të parregulluar më parë me akte të tjera ligjore ose nënligjore, ishin të tilla që mbartnin nevojën për ndërhyrjen e menjëhershme me qëllim parandalimin e pasojave të dëmshme për interesat e qytetarëve, qëllim ky që nuk mund të arrihej me mjete të tjera ligjore. Subjektet e interesuara arritën të provonin në këtë gjykim se Këshilli i Ministrave, fillimisht, dhe më pas edhe Kuvendi, kanë analizuar këto rrethana dhe situata fakti, që konsistojnë në rritjen e menjëhershme të çmimeve të produkteve ushqimore bazë në tregun shqiptar, ardhur si pasojë e situatave të ndikuara nga tregu ndërkombëtar dhe lufta Rusi–Ukrainë, çka ka sjellë pasoja në zinxhirin dhe kanalet e furnizimeve për produktet kryesore jetike të konsumit, si për shkak të importit të shumicës së këtyre mallrave nga vendet në konflikt, ashtu edhe për shkak të ruajtjes së rezervave edhe nga vendet e tjera, përmes ndalimit të eksportit të tyre. Monitorimi i çmimeve të disa produkteve ushqimore bazë përbënte një

masë në ndihmë të konsumatorit, me qëllim shmangien e mungesës së mallrave në treg, abuzimit me çmimet për këto produkte, inflacionit, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve, si dhe për lehtësimin e kostos së jetesës (*shih paragrafët 40 dhe 41 të vendimit*).

7. Shumica edhe pse nuk ka vënë në diskutim impaktin e luftës Rusi–Ukrainë dhe ka pranuar se edhe në një sërë shtetesh të tjera (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Çeki, Sllovaki, Moldavi, Lituani, Holandë, Azerbajxhan etj.) janë ndërmarrë masa konkrete për rregullimin e situatave të krijuara në vendet respektive, ka vlerësuar se relacionet bashkëshoqëruese të akteve normative të kundërshtuara nuk përmbajnë një vlerësim të ndikimit konkret në tregun kombëtar dhe konsumatorin shqiptar nga situata e krijuar në tregun ndërkombëtar dhe të efekteve të kësaj lufte në këtë situatë. Pavarësisht se në Komisionin për Ekonominë dhe Financat janë parashtruar disa argumente në këtë drejtim, ato janë vlerësuar të pamjaftueshme për të kuptuar, në këndvështrim krahasimor, ndikimin e situatës së krijuar në tregun kombëtar, si rrjedhojë e situatës në tregun ndërkombëtar, në drejtim të analizës së çmimeve të tregut para dhe pas fillimit të luftës. Sipas shumicës, edhe pse një vlerësim i tillë është paraqitur nga Këshilli i Ministrave në seancë plenare, përmes shkresës nr. 499/2, datë 2.2.2023, analiza e nevojës dhe urgjencës duhet të kryhet paraprakisht në mënyrë që të mund të kuptohet se ato kanë ekzistuar në kohën e marrjes së nismës për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kohën e kontrollit të këtyre kritereve nga Kuvendi (*shih paragrafin 43 të vendimit*).

8. Në vlerësimin tonë, parashtrimet e paraqitura nga subjektet e interesuara para Gjykatës kanë arritur pikërisht të provojnë ekzistencën e një situatë emergjente përpara miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit. Megjithatë, edhe në rast se do të pranohej ky arsyetim i shumicës në lidhje me mungesën e një analize të plotë të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit përpara miratimit të akteve të kundërshtuara, për sa kohë që gjykimi kushtetues në këto raste përfshin analizën dhe vlerësimin në themel të ekzistencës së nevojës dhe urgjencës, për Gjykatën merr rëndësi të provuarit e ekzistencës së këtyre elementeve, qoftë edhe në këtë gjykim kushtetues, për të vlerësuar se,



pavarësisht të metave me natyrë procedurale (siç mund të jetë elementi i arsytimit të akteve), nga pikëpamja materiale këto elemente kushtetuese rezultojnë të plotësuar.

9. Subjektet e interesuara arriten të argumentojnë në këtë gjykim nevojën për frenimin e spekulimit me çmimet në tregun me shumicë dhe pakicë, duke paraqitur të dhëna faktike në lidhje me rritjen e çmimeve të ushqimeve bazë, e ndikuar nga rritja e madhe e kërkesës brenda vendit dhe kufizimet e ofertës nga jashtë dhe mungesën e mekanizmave ligjorë për kontrollin e rezervave ushqimore nga tregtuesit me shumicë. Këto të dhëna tregojnë kurbën në rritje të çmimeve të disa produkteve ushqimore bazë dhe tendencën e tyre për të arritur nivele të pakontrollueshme, si për shkak të faktorëve objektivë, për shembull ato që lidhen me situatat e ndikuara nga tregu ndërkombëtar, ashtu edhe subjektivë, që lidhen me spekulimet për shkak të rritjes së lartë të kërkesës. Urgjenca e ndërhyrjes ka të bëjë me garantimin e furnizimit me produkte ushqimore të popullatës nëpërmjet kërkesës për ruajtjen e stokut 3-mujor me produkte ushqimore për çdo importues; kontrollin mbi rritjen spekulative të çmimeve nëpërmjet përcaktimit të marzheve bruto të tregtimit, bazuar në marzhet bruto të deklaruara nga operatorët në bilancet e viteve të kaluara; kufizimin e rrezikut për rritje spekulative të çmimeve në një situatë lufte në lindje të Evropës.

10. Faktet e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në këtë gjykim janë me natyrë konkrete dhe arrijnë të evidentojnë, se në kohën e miratimit të aktit normativ nr. 7/2022 ka ekzistuar një situatë të jashtëzakonshme dhe urgjente nevojë, që lidhet me situatën e tregjeve në lindje të Evropës për shkak të luftës, nga të cilat importohet një numër i madh produktesh bazë ushqimore, ekzistencën e kontratave të tregtimit me shumicë për mallra që vijnë nga këto tregje, rrezikun e mbylljes së tyre, luhatjet e çmimeve të këtyre produkteve dhe rrezikun e rritjes së pakontrolluar të tyre. E gjithë kjo situatë ka prekur jo vetëm vendin tonë, por edhe shtetet e tjera dhe është provuar se ato kanë reaguar në lidhje me këtë situatë, duke marrë masa ligjore me të njëjtin qëllim: mbajtjen nën kontroll nga shteti të çmimeve, duke garantuar edhe fitimin e importuesve dhe tregtuesve; sigurimin në tregun e brendshëm të rezervave.

11. Në kontekstin e rrethanave në të cilat është miratuar akti normativ nr. 7/2022, ai ka ardhur si rezultat i nevojës së realizimit të një kuadri ligjor të posaçëm të krijuar nga një situatë konkrete dhe e jashtëzakonshme dhe është diktuar nga nevoja për sanksionimin e masave me qëllim parandalues ndaj një kategorie të caktuar subjektsh dhe për një kategori të caktuar produktesh, për të cilat kishte rrezik evident të abuzimit në dëm të konsumatorit.

12. Shumica ka vlerësuar se Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi nuk kanë dhënë asnjë arsye se pse instrumentet ligjore dhe institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për realizimin e qëllimit që kërkohet të arrihet për mbrojtjen e konsumatorit nga praktikat abuzive dhe në përmbajtje të akteve e dokumenteve shoqëruese nuk rezultojnë argumente mbi arsyet e shkaqet që do të justifikonin përdorimin e këtij mjeti për arritjen e menjëhershme të rezultatit në treg (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Megjithatë, as kërkuesi dhe as shumica në vendimin e saj nuk kanë qartësuar se cilave mekanizmave/instrumenteve ekzistues ligjorë u referohen, ndërkohë që gjatë gjykimit u provua se nuk ka aktualisht mekanizma ligjorë për kontrollin e rezervave ushqimore, që është një nga faktorët kryesorë që impononte marrjen e masave urgjente. Mekanizma të tjerë si ulja ose ndryshimi i taksave ekzistuese ose të tjera, jo vetëm që janë masa që do të kërkonin kohë më të gjatë për arsyetimin dhe miratimin e tyre, por as nuk rezultoi gjatë këtij gjykimi që efektet që do të sillte përdorimi i tyre do të ishin të njëjta me ato që solli miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit. Në lidhje me mekanizmat institucionale ekzistues përsëri nuk është e qartë se cilëve u referohet shumica, por nëse do t'i referohemi Autoritetit të Konkurrencës, ky organ ka për objekt dhe qëllim të veprimtarisë mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, që në këtë rast nuk përfshihet në aspektet që ka synuar të rregullojë akti normativ me fuqinë e ligjit, dhe as në çështjet që ka për kompetencë të rregullojë Bordi i Transparencës.

13. Sipas shumicës, argumentet se pse rasti paraqet nevojë dhe urgjencë dhe pse nuk mund të procedohet përmes miratimit të ligjeve me procedurë normale ose të përsheptuar, duhet të gjejnë vend në relacionet përkatëse. Edhe pse akti normativ me fuqinë e ligjit sjell efekte të menjëhershme që në momentin e miratimit, vetëm ky fakt nuk mund të justifikojë përdorimin e këtij



instrumenti kushtetues me karakter përjashtimor për rregullimin e çdo situatë ligjore, duke pasur parasysh se disa situata mund të rregullohen edhe me nismë ligjore nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, si dhe me procedurë të përshpejtuar, sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës (*shih paragrafin 45 të vendimit*).

14. Në lidhje me këtë argument të shumicës vlerësojmë se për nga mënyra se si është paraqitur, ai ka marrë karakter formal dhe nuk është e qartë nëse në të ardhmen, në raste të ngjashme, palët do të pasqyronin në aktet përkatëse (relacioni bashkëshoqërues i projektaktit dhe relacionet e komisioneve të Kuvendit) faktin se rasti konkret nuk justifikon përdorimin e mjeteve të tjera ligjore, qoftë edhe procedurën e përshpejtuar, a do të ishte kjo e mjaftueshme për të justifikuar miratimin e aktit në kushtet e urgjencës?

15. Duke iu referuar procedurës për miratimin e akteve ligjore me procedurë të përshpejtuar, rregullorja e Kuvendit, në nenin 28, parashikon veprimet procedurale që duhet të zbatohen gjatë shqyrtimit dhe miratimit të një projektligji. Kërkesa e Këshillit të Ministrave ose e një të pestës së deputetëve i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Afati, brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare, nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare dhe Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar në programin 9-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendarin 3-javor të punimeve të tij. Edhe pse legjislacioni në fuqi ka parashikuar mundësinë e miratimit të akteve ligjore me procedurë të përshpejtuar, që nënkupton një afat kohor më të shkurtër për shqyrtimin e tyre nga Kuvendi, vlerësojmë se argumenti i “urgjencës” në rastin konkret e bën të pamundur rregullimin e situatës qoftë sipas kësaj procedure, për sa kohë që pasojat e ardhura ishin të tilla që nuk lejonin kohën e nevojshme për zbatimin e saj, edhe nëse nga Kuvendi do të respektoheshin në mënyrë strikte afatet e mësipërme.

16. Për të gjitha argumentet e parashtruara më sipër, ne gjyqtarët në pakicë arrijmë në përfundimin se në rastin konkret Këshilli i Ministrave ka vepruar brenda kufijve të diskrecionalitetit të këtij organi në vlerësimin e situatës së jashtëzakonshme dhe të nevojës urgjente për miratimin e akteve normative me fuqinë e ligjit dhe në përputhje me kriteret e parashikuara nga neni 101 i Kushtetutës. Aktet normative me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 dhe nr. 9/2022 janë nxjerrë në kushtet e nevojës dhe urgjencës, për rrjedhojë ato janë në përputhje me parashikimet e nenit 101 të Kushtetutës.

17. Megjithatë, siç jemi shprehur në fillim të këtij mendimi në pakicë, ndërsa gjyqtari Sandër Beci është ndalur në vlerësimin e kriterëve kushtetues të nenit 101 të Kushtetutës, duke e konsideruar kërkesën të pabazuar në tërësinë e saj, unë gjyqtarja Holta Zaçaj kam vijuar më tej edhe me vlerësimin e përmbajtjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022, duke arritur në përfundimin se neni 10, pika 2, i tij është i papajtueshëm me nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk respekton kriterin e kufizimit me ligj të të drejtave dhe lirive themelore.

18. Gjykata ka theksuar se në rastin e *rezervës ligjore absolute* është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin e *rezervës ligjore relative* çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore (*shih vendimet nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 19, datë 9.7.2009; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, shprehja “vetëm me ligj”, në nenin 17 të Kushtetutës, ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të Kuvendit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Qëllimi i këtij kriteri është ofrimi i garancive sa më të plota në rastin e kufizimeve dhe për këtë shkak kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht organi më i lartë ligjvënës. Konteksti në të cilin është përdorur togfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta. Gjykata ka çmuar se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj ka të bëjë edhe me përcaktimin e



kompetencës së një organi konkret, që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në nenin 2 të aktit normativ nr. 7/2022 është dhënë përkufizimi i situatës së veçantë në kuptim të këtij akti dhe, sipas pikës 2 të tij, situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë që, sipas nenit 12, me hyrjen e tij në fuqi shpallet edhe situata e veçantë, në kuptim të nenit 2, dhe fillojnë të zbatohen të gjitha dispozitat e këtij akti normativ. Edhe pse në vlerësimin tim pika 2 e nenit 2 duket sikur mbart paqartësi në drejtim të zbatueshmërisë së saj, përmbajtja e nenit 12, i cili referon në mënyrë të shprehur në nenin 2, e ka riparuar këtë të metë të normës, duke qenë se sipas kësaj dispozite situata e veçantë shpallet me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ nga ku fillojnë të zbatohen edhe dispozitat e tij.

20. Duke iu referuar më tej nenit 10 të këtij akti, i titulluar “Kohëzgjatja dhe zbatimi”, ndërsa në pikën 1 shprehet se parashikimet e tij zbatohen për aq kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë të krijuar në treg, në pikën 2 parashikon se: “Zbatimi i parashikimeve të këtij akti normativ fillon me shpalljen e situatës së veçantë, me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfundimi i situatës së veçantë përcaktohet me vendim të Bordit.”. Në vlerësimin tim kjo dispozitë përfaqëson një kufizim të ri, përtej atyre që bën vetë akti normativ, i cili konsiston në dy elemente: me një akt normativ me fuqinë e ligjit, i cili plotëson kërkesën kushtetuese për vendosjen e kufizimeve me ligj, delegohet kompetenca për vlerësimin e situatës së veçantë (fillimit dhe mbarimit të saj); formulimi i normës shfaq probleme të qartësisë dhe parashikueshmërisë së saj. Parashikimi i nenit 10, pika 2, duke deleguar kompetencën për ndërhyrje në akte të tjera me karakter nënligjor përmban një tejkalim të çështjeve të cilat Kushtetuta ka autorizuar Këshillin e Ministrave apo organe të tjera të rregullojë. Edhe vetë Kuvendi, me miratimin e këtij akti normativ me ligj, ka pranuar delegimin e pushtetit të tij në organe të tjera, Këshilli i Ministrave dhe Bordi i Transparencës, në kundërshtim me doktrinën e

mosdelegimit, që ndalon delegimin e pushtetit legjislativ edhe me vullnetin e organit përtej rasteve që lejon norma kushtetuese.

21. Në kuadër të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, në tekstin e ligjit çdo fjalë mbart një kuptim të caktuar që i shërben qëllimit të vetë ligjit, nga njëra anë, dhe aspektit të parashikueshmërisë së normave juridike, nga ana tjetër (*shih vendimin nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur kontrollohet kushtetutshmëria e ndërhyrjeve në të drejtat e njeriut, vlerësimi i kriterit “kufizimi vetëm me ligj” analizohet si në aspektin formal, në kuptimin nëse ndërhyrja parashikohet nga ligji i miratuar nga Kuvendi, ashtu edhe në aspektin substancial, në kuptimin se sa ligji ofron garancitë e mjaftueshme për ndërhyrjen (*shih vendimin nr. 30, datë 5.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të parimit të sigurisë juridike, një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se ligji që kufizon të drejtat kushtetuese duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë: ai duhet të jetë i aksesueshëm për të interesuarin (në kuptim të marrjes dijeni) dhe i parashikueshëm për efektet e tij. Po kështu, ligji duhet të jetë mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t’u japë qytetarëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre. Me fjalë të tjera, kur Gjykata kontrollon aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimin nr. 30, datë 2.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Edhe sipas GJEDNJ-së, një normë nuk mund të konsiderohet si “ligj” nëse ajo nuk është formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i lejuar personave të cilëve u drejtohet që të rregullojnë sjelljen e tyre dhe që të mund të jenë në gjendje të parashikojnë, në një masë që është e arsyeshme, pasojat që mund të mbartë një veprim i caktuar



(shih *Perinçek k. Zvicrës [DhM]*, § 131). Qëllimi i koncepteve të parashikueshmërisë dhe aksesueshmërisë varet në një shkallë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, fusha që synon të mbulojë dhe numri dhe statusi i atyre të cilëve u drejtohet (shih *Chaunry dhe të tjerë k. Francës*, §§ 43-45). Qëllimi i nocionit të parashikueshmërisë varet nga konteksti në të cilin masat kufizuese në fjalë përdoren (shih *Magyar Kétfarkú Kutya Párt k. Hungarisë [DhM]*, § 99). Sipas GJEDNJ-së, fakti që një dispozitë ligjore është e aftë për më shumë se një interpretim, nuk nënkupton se nuk plotëson kriteret e parashikueshmërisë (shih *Perinçek k. Zvicrës [DhM]*, § 135; *Vogt k. Gjermanisë*, § 48, në lidhje me nenin 10). Në vlerësimin e parashikueshmërisë së ligjit, GJEDNJ-ja verifikon edhe cilësinë e tij, në lidhje me qartësinë dhe saktësinë. Shprehja “e parashikuar me ligj” nuk kërkon vetëm që masat e kundërshtuara duhet të kenë bazë në ligjin e brendshëm, por i referohet edhe aksesueshmërisë dhe cilësisë së ligjit në fjalë (shih *NIT S.R.L. k. Republikës së Moldovës [DhM]*, § 163). GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje të kërkesës që ndërhyrja duhet të jetë e ligjshme, në rastin kur ka vënë re një kontradiktë ndërmjet dy teksteve ligjore dhe në mungesë të një zgjidhjeje të qartë (shih *Goussev dhe Marenk k. Finlandës*, § 54).

23. Në vlerësimin tim, edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative, nuk është e qartë se përse është zgjedhur kjo mënyrë e formulimit të dispozitave të aktit normativ me fuqinë e ligjit, duke qenë se nga njëra anë vetë akti normativ ka përcaktuar momentin se kur shpallet situata e veçantë dhe kur fillojnë efektet e saj, kurse nga ana tjetër parashikon kompetencën e Këshillit të Ministrave për shpalljen e situatës së veçantë dhe atë të Bordit për përfundimin e saj.

24. Sipas pikës 1 të nenit 10 parashikimet e këtij akti zbatohen për atë kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë, çka edhe pse nënkupton se efektet e tij janë të përkohshme, në mungesë të përcaktimit të afatit në të cilin do të gjejnë zbatim këto rregulla për transparencën dhe monitorimin e situatës, ashtu edhe të kriterëve e standardeve mbi të cilat do të vlerësohet shpallja dhe përfundimi i situatës së veçantë, përmbajtja e pikës 2 të nenit 10 krijon dyshime për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të saj, që mund të përbëjë edhe shkak për arbitraritet gjatë veprimtarisë së këtyre organeve.

25. Në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar se, si rregull, çdo kufizim i të drejtave në vetvete duhet të ketë elementin e përkohshmërisë. Kur kufizimet zgjasin pa afat, duke humbur karakteristikën e përkohshmërisë dhe për kohëzgjatjen e pacaktuar nuk jepet justifikim, ato shndërrohen në ndalim tërësor të kësaj të drejte, duke zbehur rolin që luajnë mënyrat alternative (shih *vendimin nr. 11, datë 9.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur parasysh natyrën e aktit normativ me fuqinë e ligjit, si edhe qëllimin për të cilin është miratuar akti normativ nr. 7/2022, kriteri i përkohshmërisë së efekteve të tij, edhe pse është reflektuar në pikën 1 të nenit 10, nuk konsiderohet i përmbushur për sa kohë që ky akt duhet të kishte përcaktuar ose një afat kohor në të cilin do të sjellë efektet e tij kufizuese, në përfundim të të cilit do të duhej të rivlerësohej situata konkrete, pra nëse do të kërkohej sërish ndërhyrja me akt normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave ose me ligj nga Kuvendi, ose duhej të kishte përcaktuar kriteret të qarta për përfundimin e situatës së veçantë, në prani të të cilave ky akt do të pushonte efektet e tij, duke mos e lënë këtë vlerësim në diskrecion të organeve të tjera, qoftë edhe vetë Këshilli i Ministrave. Në këtë mënyrë, me nenin 10, pika 2, i është deleguar një organi të ndryshëm nga ligjvënësi e drejta për të vendosur ose hequr me akt nënligjor masat kufizuese, çka bie ndesh me konceptin e kufizimit me ligj të të drejtave, si në aspektin formal ashtu edhe substancial.

26. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se përmbajtja e nenit 10, pika 2, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7/2022 është e papajtueshme me nenin 17 të Kushtetutës.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtar: Sandër Beci



VENDIM

Nr. 9, datë 23.2.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.2.2023
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 4 (P) 2022 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Petrit Hysi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtoria Rajonale Tatimore, Lezhë,

Drejtoria e Apelit pranë Ministrisë së
Financave dhe Ekonomisë,

Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 895
(1373), datë 28.12.2021, të Gjykatës Administrative
të Shkallës së Parë Shkodër, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 4, pika 1, 15, pika 2,
17, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1,
shkronja “I”, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6
dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e
Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 81, pika 3, të ligjit
nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori
në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesës, i
cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet
me shkrim të subjekteve të interesuara, të
përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, të cilat kanë
kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Petrit Hysi ushtron profesionin e
avokatit dhe është anëtar i Dhomës së Avokatisë,
Lezhë, nga viti 1993 e në vazhdim. Nga data
10.6.2014 ai përfiton edhe pensionin e pleqërisë.

2. Referuar ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për
sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,
të ndryshuar (ligji nr. 7703/1993 ose ligji për sigurimet
shoqërore) dhe nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për
sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në
Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 10383/2011 ose
ligji për sigurimet shëndetësore), si person tjetër
ekonomikisht aktiv (i vetëpunësuar), kërkuesi ka
qenë subjekt i skemës së sigurimeve të
detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, duke
pasur detyrimin për pagimin e kontributeve të
detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe
shëndetësore. Këto ligje dhe aktet nënligjore në
zbatim të tyre, krahas personave të siguruar, pra të
atyre që mbartin detyrimin për pagimin e
kontributeve të detyrueshme, përcaktojnë edhe
llojin dhe masën e këtyre kontributeve.

3. Nga ana tjetër, mbledhja e kontributeve të
detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të
kontributeve të detyrueshme të sigurimeve
shëndetësore, sipas ligjeve të sipërpërmendura,
rregullohet me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për
mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të
sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në
Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.
9136/2003 ose ligji për mbledhjen e kontributeve të
detyrueshme). Sipas këtij ligji, kontributet e
detyrueshme mbledhen nga organet tatimore për
llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe
Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit
Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji
dhe të akteve të tjera nënligjore. Ky ligj rregullon
procedurat për mbledhjen e kontributeve të
detyrueshme, duke përcaktuar edhe përgjegjësinë e
personit të detyruar për të paguar kontributet, për
llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e tyre në kohën
dhe në masën e duhur.

4. Ligjit për sigurimet shoqërore i janë bërë disa
shtesa me ligjin nr. 144/2015, miratuar në datën
17.12.2015. Kështu, iu shtua shkronja “d” në
paragrafin e dytë të nenit 6 që rregullonte mbrojtjen



e detyrueshme. Sipas këtij paragrafi “[...] Këshilli i Ministrave mund të vendosë [...] për përjashtime për: [...]; d) pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji.”. Po ashtu, i është shtuar paragrafi i pestë në nenin 9 që rregullonte llojet e kontributeve për t’u paguar, i cili parashikonte se “për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, [...] profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, si dhe kriteret e përcaktimit të saj, nga paga minimale deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave”.

5. Po në datën 17.12.2015 u miratua ligji nr. 145/2015 përmes të cilit janë bërë disa shtesa në ligjin për sigurimet shëndetësore. Kështu, u shtua një fjali, në pikën 1 të nenit 5, që rregullonte personat e siguruar. Pas kësaj shtese, kjo pikë, ndër të tjera, parashikonte se “sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përbërshëm në Shqipëri, si:[...]; b) personat e vetëpunësuar, me përjashtim të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 7, të këtij ligji, të cilët nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute të sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Po ashtu, u shtua pika 3 në nenin 7 që rregullonte bazën për llogaritjen e kontributeve. Pika e shtuar parashikonte se: “për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, [...] profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, nga paga minimale deri në pagën maksimale, si dhe kriteret e përcaktimit të saj caktohen nga Këshilli i Ministrave”.

6. Edhe ligji për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme pësoi ndryshime përmes ligjit nr. 143/2015, i miratuar po në datën 17.12.2015. Kështu, u ndryshua pika 3 e nenit 6 që rregullonte detyrimet e personave që paguajnë kontributet. Pika e ndryshuar parashikonte se: “Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor”. Po ashtu, u ndryshua edhe neni 9 që rregullonte llogaritjen e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes. Pika 1 e këtij neni të ndryshuar parashikonte kriteret dhe

formatat e llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe atyre shëndetësore për personin e vetëpunësuar, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Po ashtu, kjo pikë parashikonte se për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit shëndetësor, nga paga minimale deri në pagën maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave. Së fundi, sipas kësaj pike, Këshilli i Ministrave ngarkohej për nxjerrjen e vendimit për zbatimin e saj.

7. Këshilli i Ministrave, bazuar në tre ligjet e mësipërme, miratoi vendimin nr. 37, datë 21.1.2016 “Për përcaktimin e pagës mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit shëndetësor për personat e regjistruar si të vetëpunësuar, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale dhe punonjësit e papaguar që punojnë e bashkëjetojnë me të” (VKM-ja nr. 37/2016). Objekt i këtij vendimi ishin personat e regjistruar si persona fizikë, me ose pa të punësuar, si dhe me ose pa punonjës të papaguar të familjes që punonin e bashkëjetonin me të vetëpunësuarin, të cilët kryenin veprimtari ekonomike në një ose disa nga profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 që i bashkëlidhej vendimit (pika 1). Krahas rregullimeve në lidhje me pagat mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në pikën 9 të këtij vendimi, ndër të tjera, u parashikua se “mbështetur në pikën 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, [...] pensionistët e regjistruar si persona fizikë të vetëpunësuar të vetëm, që punojnë në profesionet e përcaktuara në aneksin nr. 1 të këtij vendimi, nuk kanë detyrim për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore [...]”. Ky vendim i Këshillit të Ministrave u botua në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 29.1.2016 dhe hyri në fuqi menjëherë.

8. Kërkuesi, bazuar në kuadrin ligjor të lartpërmendur, pas datës 29.1.2016 u përjashtua nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për shkak se ishte pensionist, i regjistruar si person fizik i vetëpunësuar, i vetëm, që punonte në profesionin e avokatit dhe përfshihej në profesionet e përcaktuara në VKM-në nr. 37/2016.



9. Ndërkohë ligji nr. 143/2015, që ka ndryshuar ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, si dhe VKM-ja nr. 37/2016, me kërkesë të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, janë bërë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 60, datë 19.6.2016 (*vendimi nr. 60/2016*), ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr. 143/2015, si dhe të VKM-së nr. 37/2016, me arsyetimin se cenoheshin parimet e barazisë para ligjit, të sigurisë juridike, si dhe të hierarkisë së akteve normative. Vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës ka hyrë në fuqi në datën 20.9.2016, kur është botuar në Fletoren Zyrtare.

10. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbetën në fuqi shtesat e bëra në ligjin për sigurimet shoqërore të miratuara me ligjin nr. 144/2015, që parashikonin mundësinë e përjashtimit nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personat e tjerë ekonomikisht aktivë, atyre të vetëpunësuar, specifikisht të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, këto rregulla ishin të pazbatueshme për sa kohë mungonte vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kategorive të veçanta të personave, ndërsa VKM-ja nr. 37/2016 u shfuqizua.

11. Për të njëjtën shkak, mbetën të pazbatueshme edhe shtesat e bëra në ligjin për sigurimet shëndetësore, të miratuara me ligjin nr. 145/2015, sikundër edhe ndryshimet e bëra në ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, të miratuara me ligjin nr. 143/2015. Në këtë situatë, kuadri ligjor nuk përcaktonte më ndonjë kategori të veçantë të personave, të pensionistëve të vetëpunësuar që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, të cilët përjashtoheshin nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndaj detyrimi për pagimin e këtyre kontributeve edhe për pensionistët e vetëpunësuar u bë përsëri efektiv, për sa kohë ata janë subjekte të skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor dhe përfshihen në kategorinë e personave të tjerë ekonomikisht aktivë (të vetëpunësuar).

12. Në një njoftim për shtyp të datës 14.10.2016, të publikuar në faqen zyrtare të

Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, tatimpaguesit janë njoftuar për vendimin e Gjykatës nr. 60/2016 dhe se, në bazë të këtyre ndryshimeve, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar do të bëhet 23% mbi pagën minimale (22,000 lekë), ndërsa për kontributin e sigurimeve shëndetësore llogaritja do të bëhet 3.4% mbi dyfishin e pagës minimale (22,000 lekë) të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

13. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*akti normativ nr. 1/2017*). Ky akt normativ ka hyrë në fuqi në datën 25.1.2017. Nga ana tjetër, akti normativ është miratuar me ndryshime me ligjin nr. 25/2017, i cili ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 27.3.2017. Nëpërmjet këtij akti normativ janë bërë disa ndryshime në ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, si dhe disa shfuqizime në ligjin për sigurimet shoqërore dhe në ligjin për sigurimet shëndetësore.

14. Si rrjedhojë e aktit normativ nr. 1/2017, ligji për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme nuk parashikon më përjashtimin nga detyrimi për pagimin e kontributeve për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor për kategorinë e pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike të caktuara profesionale, si dhe as delegimin për Këshillin e Ministrave që të caktojë me vendim pagën për efekt të llogaritjes së kontributeve për kategori të veçanta personash. Në të njëjtën linjë, me aktin normativ janë shfuqizuar: (i) në ligjin për sigurimet shoqërore delegimi për Këshillin e Ministrave për të vendosur përjashtime për pensionistët që ushtrojnë veprimtari ekonomike të caktuara profesionale; (ii) në ligjin për sigurimet shëndetësore përjashtimi nga detyrimi për pagimin e kontributeve të pensionistëve të vetëpunësuar që ushtrojnë veprimtari ekonomike të caktuara profesionale.

15. Për sa më lart, me hyrjen në fuqi të aktit normativ nr. 1/2017, i cili është miratuar edhe në Kuvend, kuadri ligjor nuk parashikon më mundësinë e përjashtimit nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve



shoqërore dhe shëndetësore për personat e tjerë ekonomikisht aktivë, atyre të vetëpunësuar, specifikisht të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike të caktuara profesionale (sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave), ashtu sikundër as delegimin për Këshillin e Ministrave për të përcaktuar kategoritë e veçanta të këtij grupi personash.

16. Më datë 18.12.2018 kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Lezhë (DRT, *Lezhë*) me kërkesë për sqarime lidhur me rregullimet ligjore, pas vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DRT-ja, Lezhë, me shkresën nr. 9055/1 prot., datë 8.1.2019, ka sqaruar kërkuesin, duke u shprehur se VKM-ja nr. 37/2016 është shfuqizuar me vendimin nr. 60/2016 të Gjykatës dhe për çdo ndryshim ligjor dhe nënligjor në legjislacionin tatimor administrata tatimore njofton tatimpaguesin nëpërmjet faqes së tij të deklaramit elektronik. Sipas DRT-së, Lezhë kërkuesi kishte detyrimin për të deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga dita kur vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës ka hyrë në fuqi, 20.9.2016, kur është botuar në Fletoren Zyrtare.

17. Në datën 18.1.2019 kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor (DAT) me ankim për kundërshtimin e shkresës nr. 9055/1 prot., datë 8.1.2019 të DRT-së, Lezhë. Në përgjigje të këtij ankimi, DAT-ja, me shkresën nr. 241/1 prot., datë 28.2.2019, i ka kthyer përgjigje kërkuesit se shkresa e tij për dhënie informacioni nuk mund të jetë objekt ankimi në DAT, duke qenë se nuk plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 106 të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9920/2008) dhe në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, të dalë në zbatim të tij, sipas të cilave: “*Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin*”. Për këtë arsye, DAT-ja e ka sqaruar kërkuesin që të plotësojë ankimin e tij me dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditësh, duke pasur në konsideratë nenet 106 dhe 107 të ligjit nr. 9920/2008.

18. Më pas, DRT-ja, Lezhë, në datën 20.2.2019, në zyrën e kontrollit tatimor, ka mbajtur aktvlerësimin ndaj kërkuesit bazuar në

informacionin e ardhur *online*, si dhe në shkresën e datës 13.2.2019. Në përmbajtje të aktvlerësimit konstatohet se DRT-ja, Lezhë është shprehur se VKM-ja nr. 37/2016 është shfuqizuar me vendimin nr. 60/2016 të Gjykatës, të botuar në Fletoren Zyrtare të datës 20.9.2016 dhe se bazuar në ligjin nr. 9136/2003, si dhe në nenin 68, pika 4, të ligjit nr. 9920/2008, ajo bën vlerësimin tatimor nga data 17.11.2016 e në vazhdim. Në vijim të këtij akti vlerësimi, DRT-ja, Lezhë, në datën 21.2.2019 ka nxjerrë aktin administrativ nr. 1161/3 prot. “Njoftimvlerësimi për detyrimet”, i cili krahas detyrimeve tatimore caktonte edhe gjobë ndaj kërkuesit, gjithsej në shumën 232,596 (dyqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

19. Në datën 12.3.2019 kërkuesi ka paraqitur ankim te DAT-ja ndaj aktit administrativ nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 të DRT-së, Lezhë. Ndërkohë, në datën 8.3.2019 ka depozituar në Bankën Amerikane të Investimeve shumën 196,000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, si garanci bankare për llogari të DRT-së, Lezhë. Me shkresën nr. 1107/1 prot., datë 21.3.2019, DAT-ja i ka bërë me dije kërkuesit se mandatarkëtimi për derdhjen e garancisë bankare, i paraqitur prej tij, nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara në nenin 107 të ligjit nr. 9920/2008, sipas të cilit tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë njoftimvlerësimin, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor. Për këtë arsye, DAT-ja i ka lënë afat të plotësojë ankimin brenda 15 ditëve. Më pas, DAT-ja, me vendimin nr. 1107/3 prot., datë 10.4.2019, ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi nuk ishte plotësuar kushti i parashikuar në nenin 107 të ligjit nr. 9920/2008.

20. Pas vendimit të DAT-së për refuzimin e ankimit, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 të DRT-së, Lezhë për njoftim vlerësimin e detyrimeve për periudhën 16 shtator 2016–dhjetor 2018, si dhe aktit administrativ nr. 1107./3 prot., datë 10.4.2019 të DAT-së për refuzimin e ankimit.

21. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 895 (1373), datë 28.12.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Në pjesën



urdhëruese të vendimit gjykata është shprehur se kundër tij nuk lejohet ankim dhe se vendimi është i formës së prerë.

22. Më datë 2.6.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 895 (1373), datë 28.12.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

23. Kolegji i Gjykatës, në datën 26.7.2022, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 11.10.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

24. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se janë cenuar:

24.1 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës nuk duhet të zbatohet drejtpërdrejt pa një rregullim ligjor, gjë që normohet në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 8577/2000. Administrata tatimore dhe për më tepër gjykata duhet të zbatojnë parimin e sigurisë juridike.

24.2 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata nuk ka respektuar e zbatuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkuarit për pretendimet e ngritura në lidhje me pavlefshmërinë e akteve administrative të DRT-së, Lezhë dhe DAT-së. Pavlefshmëria e aktit administrativ nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 është kërkuar nga kërkuesi për shkak se DRT-ja, Lezhë në nxjerrjen e këtij akti nuk ka përcaktuar bazën ligjore dhe nuk e ka njoftuar atë për shfuqizimin e VKM-së nr. 37/2016. Ajo gjykatë është përqendruar në rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke i anashkaluar pretendimet e ngritura në kërkesëpadi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka cenuar edhe afatin e arsyeshëm për arsyetimin e vendimit, pasi nuk është realizuar brenda afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

24.3 *E drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë dhe e drejta e aksesit*, pasi gjykata administrative i ka mohuar kërkuarit të drejtën e ankimit. Neni 45 i ligjit nr. 49/2012 u referohet rasteve të kundërshtimit të akteve administrative që rrjedhin nga kryerja e kundërvajtjeve administrative dhe akteve administrative me detyrim më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Në rastin konkret nuk ndodhemi në asnjë prej këtyre rasteve, pasi nuk kemi të bëjmë me kundërshtimin e aktit të dalë për kryerjen e kundërvajtjes administrative ose pagesës së detyrimeve. Gjithashtu, gjykata, për llogaritjen e vlerës së dëmit apo të detyrimit në raport me pagën minimale në shkallë vendi, duhet të caktonte një ekspert, pasi shumica reale për t’u paguar ka qenë më e lartë se njëzetfishi i pagës minimale.

25. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

25.1 Kërkuesi nuk ka ngritur asnjë çështje kushtetutshmërie lidhur me cenimin e parimit të *sigurisë juridike*, por kërkon nga Gjykata t’u jepet zgjidhje pretendimeve të tij për themelin e çështjes. Në rastin konkret, kërkuesi është sqaruar se në bazë të ligjit të procedurave tatimore, për çdo ndryshim ligjor dhe nënligjor në legjislacionin tatimor, administrata tatimore njofton tatimpaguesin nëpërmjet faqes së tij të deklarimit elektronik, e cila administrohet nga vetë kërkuesi. Kërkuesi nuk mund të pretendojë cenimin e parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që ligjvënësi e ka rregulluar në nenin 28 të ligjit nr. 9920/2018 mënyrën e komunikimit me personat fizikë/juridikë, në lidhje me ndryshimet e legjislacionit tatimor.

25.2 Pretendimi i kërkuarit për cenimin e *standardit të arsyetimit* është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër përmbush kërkesat e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit. Ai vendim është i plotë, duke specifikuar referencat ligjore si të legjislacioni i posaçëm tatimor, ashtu dhe ai procedural i përgjithshëm. Vendimi i kundërshtuar është i qartë, logjik dhe ka analizuar të gjithë të rrethanat faktike ligjore. Gjithashtu, janë analizuar të gjitha pretendimet e parashtruara nga kërkuesi. Për sa i përket pretendimit për mosarsyetimin e vendimit brenda afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, kërkuesi nuk ka arritur të



vërtetojë cenimin e interesit të ligjshëm në lidhje me sa pretendon dhe nuk ka sjellë asnjë argument se çfarë pasoje i ka ardhur atij nga vonesa në arsyetim.

25.3 Pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së ankimit dhe të së drejtës së aksesit janë të pabazuara, pasi është ai vetë që ka vënë në lëvizje Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila në asnjë moment nuk ka arsyetuar për kundërvajtje administrative ose pagim detyrimi, siç pretendon kërkuari. Neni 45 i ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar në mënyrë të qartë se nëse objekt i shqyrtimit gjyqësor në gjykatat administrative është kundërshtimi i aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi, atëherë ky është një vendim i paankimueshëm dhe merr formë të prerë. Vlera e përcaktuar në njoftimin tatimor, objekt gjykimi, është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

26. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

27. Në këtë këndvështrim, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

28. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131,

pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuari ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

29. Në rastin konkret, kërkuari i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 895 (1373), datë 28.12.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, i cili është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Në këto rrethana, kërkuari nuk ka mjete të tjera ankimi, ndaj Gjykata vlerëson se ai ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

30. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1/b, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar nga kërkuari mban datën 28.12.2021, ndërsa ankimi kushtetues është paraqitur në Gjykatë në datën 2.6.2022. Sipas akteve të dosjes gjyqësore, të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkuari ka marrë dijeni për vendimin e kundërshtuar në datat 7.3.2022 dhe 16.5.2022. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ankimi kushtetues është paraqitur është brenda afatit ligjor.

31. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e kërkuarit për mosarsyetimin e vendimit brenda afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, në kushtet kur ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor, Gjykata çmon se në rastin konkret ai nuk provon cenimin e së drejtës për proces të rregullt nga vonesa në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se, ashtu sikurse ka prapësuar edhe subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, kërkuari nuk ka arritur të vërtetojë cenimin e interesit të ligjshëm në lidhje me këtë pretendim dhe nuk ka sjellë ndonjë argument kushtetues në lidhje me



pasojën që i ka ardhur nga vonesa në arsyetim. Për këtë arsye, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

32. Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në aspektet e parimit të sigurisë juridike, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit. Këto elemente të procesit të rregullt garantojnë respektivisht nga nenet 4, 42, 43 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Si të tilla, ato hyjnë në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të shqyrtohet bazueshmëria e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

33. Kërkuari ka pretenduar se organet tatimore dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, për shkak se vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës nuk duhet të zbatohet drejtpërdrejt pa një rregullim ligjor, gjë që normohet në pikën 2 të nenit 81 të ligjit nr. 8577/2000.

34. Sipas subjektit të interesuar, kërkuari nuk ka ngritur asnjë çështje kushtetutshmërie, por kërkon nga Gjykata që t'u jepet zgjidhje pretendimeve të tij për themelin e çështjes. Në rastin konkret, kërkuari është sqaruar se në bazë të ligjit të procedurave tatimore, për çdo ndryshim ligjor dhe nënligjor në legjislacionin tatimor, administrata tatimore njofton tatimpaguesin nëpërmjet faqes së tij të deklarimit elektronik, e cila administrohet nga vetë kërkuari.

35. Në rastin konkret, pavarësisht mënyrës se si i ka parashtruar kërkuari argumentet e tij për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata konstaton se, në thelb, ai pretendon se pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës që ka shfuqizuar nenin 4 të ligjit nr. 143/2015, i cili ka ndryshuar nenin 9 të ligjit nr. 9136/2003 dhe VKM-në nr. 37/2016, organet tatimore nuk kanë pasur asnjë bazë ligjore për vlerësimin që i kanë bërë atij për pagimin e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor.

36. Siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës si një prej parimeve themelore të organizimit shtetëror (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 81, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha

organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 60, datë 16.9.2016; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në vijim të kësaj jurisprudence, Gjykata ka theksuar se të gjitha organet, e parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t'i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë dhe atij të ligjshmërisë, pasi vetëm në këtë mënyrë garantohet shteti i së drejtës. Duke pasur parasysh se shteti ka për detyrë respektimin dhe mbrojtjen e bazave (vlerave themelore), të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, Gjykata nënvizon se organet shtetërore në aktet që miratojnë dhe në veprimet që kryejnë, nga njëra anë, duhet të frymëzohen nga këto vlera themelore (neni 3), por, nga ana tjetër, ato njëkohësisht duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, pra që veprimtaria e tyre të jetë e bazuar tek e drejta në kuptimin e gjerë (*latu sensu*), e cila përfshin jo vetëm Kushtetutën, por edhe kuadrin ligjor respektiv (neni 4). Megjithatë, shteti i së drejtës nuk konsiston vetëm në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike nga organet shtetërore, por në sigurimin e kontrollit gjyqësor se si autoritetet respektojnë këto norma juridike (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se referuar ligjeve nr. 7703/1993 dhe nr. 10383/2011 kërkuari ka qenë subjekt i skemës së sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, duke pasur detyrimin për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Mbledhja e këtyre kontributeve rregullohet nga ligji nr. 9136/2003. Gjykata më sipër ka konstatuar në vendim se këto ligje kanë pësuar ndryshime me ligjet nr. 143/2015, nr. 144/2015 dhe nr. 145/2015 (*shih paragrafët 4-6 të këtij vendimi*), të cilat kanë parashikuar përjashtimin e një kategorie të caktuar individësh nga pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor. Për të realizuar efektivisht në praktikë këto përjashtime në pagesën e kontributeve, Këshilli i Ministrave, në zbatim të delegimit të bërë nga ligjet e mësipërme, ka miratuar vendimin nr. 37/2016. Pas hyrjes në fuqi të këtij akti, më 29.1.2016, kërkuari është përjashtuar nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.



39. Ligji nr. 143/2015 dhe VKM-ja nr. 37/2016 janë bërë objekt kontrolli nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 60/2016, ka vendosur shfuqizimin e nenit 4 të ligjit nr. 143/2015 dhe VKM-së nr. 37/2016, si të papajftueshëm me Kushtetutën. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në datën 20.9.2016, kanë mbetur në fuqi ndryshimet ligjore të cilat parashikojnë mundësinë e përjashtimit të një kategorie të caktuar individësh në pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku përfshihen edhe kërkuesit. Megjithatë, në mungesë të VKM-së për përcaktimin e kategorive të veçanta të personave që përjashtohen nga pagesa e detyrueshme e kontributeve, parashikimet ligjore mbeten të pazbatueshme. Në këtë situatë, detyrimi i kërkuesit për pagesën e këtyre kontributeve u bë përsëri efektiv, për sa kohë që ai ishte subjekt i skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor.

40. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 1/2017, i cili ka ndryshuar ligjet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme. Për rrjedhojë, kuadri ligjor nuk parashikon më përjashtimin nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kërkuesin, ashtu sikundër as delegimin për Këshillin e Ministrave për të përcaktuar kategoritë e veçanta të këtij grupi personash.

41. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se detyrimi i kërkuesit për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor buron nga dispozitat ligjore në fuqi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për sa kohë që vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës nuk ka krijuar boshllëk ligjor, ajo çmon se nuk jemi në rastet kur është e nevojshme ndërhyja e ligjvënësit për miratimin e një norme të re për parashikimin e një detyrimi të tillë. Nga ana tjetër, ky vendim i Gjykatës nuk është shprehur për të drejtat e kërkuesit dhe nuk ka sjellë ndonjë efekt mbi të, pasi as i ka njohur dhe as i ka mohuar ndonjë të drejtë. Gjykata vlerëson se organet tatimore kanë vepruar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, i cili nuk parashikon përjashtim nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kategorinë ku përfshihet kërkuesi. Për rrjedhojë, pretendimi i

kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

42. Kërkuesi pretendon se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykata nuk ka respektuar e zbatuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit dhe nuk i ka dhënë përgjigje atij për pretendimet e ngritura për pavlefshmërinë e akteve administrative të DRT-së, Lezhë dhe DAT-së. Pavlefshmëria e aktit administrativ nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 është kërkuar nga kërkuesi për shkak se DRT-ja, Lezhë në nxjerrjen e këtij akti nuk ka përcaktuar bazën ligjore dhe nuk e ka njoftuar atë për shfuqizimin e VKM-së nr. 37/2016. Gjykata administrative është përqendruar në rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke i anashkaluar pretendimet e ngritura në kërkesëpadi.

43. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër përmbush kërkesat e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit. Vendimi objekt i këtij gjykimi kushtetues është i plotë, duke specifikuar referencat ligjore si të legjislacioni i posaçëm tatimor, ashtu dhe tek ai procedural i përgjithshëm, është i qartë, logjik dhe është marrë në analizë të rrethanave faktike e ligjore, duke arsyetuar, gjithashtu, të gjitha pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në kërkesëpadi.

44. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të



përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 28, datë 1.11.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se objekt i kërkesëpadisë së kërkuarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka qenë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve administrative nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 të DRT-së, Lezhë dhe nr. 1107/3 prot., datë 10.4.2019 të DAT-së, pasi, sipas tij, organet tatimore në nxjerrjen e akteve administrative nuk kanë përcaktuar bazën ligjore për nxjerrjen e tyre.

47. Gjykata konstaton se, në lidhje me këtë pretendim, gjykata e shkallës së parë ka analizuar dhe vlerësuar rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke u shprehur: “[...] *aktet administrative objekt gjykimi, përmbajnë elementët e nevojshëm dhe plotësojnë tërësisht kushtet formale të sanksionuara në nenet 98, 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative. Për pasojë, gjykata vlerëson se, aktet administrative të kundërshtuara gjyqësisht nuk konstatohen të jenë absolutisht të pavlefshëm në kuptim të pikës “iii”, të gurmës “a”, të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.*” (*shih faqen 17 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër*).

48. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në vendimin e saj ka analizuar dhe vlerësuar rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke u shprehur në përfundim të gjykimit se aktet administrative objekt i kërkesëpadisë nuk preken nga shkaqe që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe për këtë arsye ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit. Po ashtu, ky vendim përmban të dhënat e palëve, vendimarrjen e organeve administrative, shkaqet e ngritura në kërkesëpadi, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton

të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë.

49. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi objekt kërkesë nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i papabazuar.

B.3. Për cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë

50. Kërkuari pretendon se gjykata administrative i ka mohuar të drejtën e ankimit, pasi neni 45 i ligjit nr. 49/2012 u referohet rasteve të kundërshtimit të akteve administrative që rrjedhin nga kryerja e kundërvajtjeve administrative dhe akteve administrative me detyrim më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Në rastin konkret nuk ndodhemi në asnjë prej këtyre rasteve, pasi nuk kemi të bëjmë me kundërshtimin e aktit të dalë për kryerjen e kundërvajtjes administrative ose pagesës së detyrimeve. Gjithashtu, gjykata, për llogaritjen e vlerës së dëmit apo të detyrimit në raport me pagën minimale në shkallë vendi, duhet të caktonte një ekspert, pasi shuma reale për t’u paguar ka qenë më e lartë se njëzetfishi i pagës minimale.

51. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta e ankimit dhe e drejta e aksesit, pasi është ai vetë që ka vënë në lëvizje gjykatën administrative. Kjo e fundit në asnjë moment nuk ka arsyetuar për kundërvajtje administrative apo pagim detyrimi, siç pretendon kërkuari. Neni 45 i ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar në mënyrë të qartë se nëse objekt i shqyrtimit gjyqësor në gjykatat administrative është kundërshtimi i aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, atëherë ky është një vendim i paankimueshëm dhe ka marrë formë të prerë. Vlera e përcaktuar në njoftimin tatimor objekt gjykimi është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

52. Sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset vetëm



me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës.

53. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për cenimin e së drejtës së ankimit për shkak se ai nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 dhe gjykata administrative ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e kësaj dispozite, Gjykata konstaton se ky aspekt i pretendimit nuk është ngritur në nivel kushtetues.

54. Kërkuarësi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, sepse gjykata, për llogaritjen e vlerës së dëmit ose të detyrimit në raport me pagën minimale në shkallë vendi, duhet të caktonte një ekspert, duke qenë se shuma reale për t'u paguar ka qenë më e lartë se njëzetfishi i pagës minimale. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se kërkuarësi i referohet shkresës nr. 1798 prot., datë 11.11.2021 të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior, e cila nuk ka qenë objekt i procesit gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, në përcaktimin e vlerës së kërkesëpadisë, i është referuar aktit administrativ nr. 1161/3 prot., datë 21.2.2019 të DRT-së, Lezhë, objekt i atij gjykimi, në bazë të të cilit është shprehur në lidhje me të drejtën e ankimit gjyqësor të kërkuarit. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka disponuar për të drejtën e ankimit sipas objektit të kërkesëpadisë së paraqitur përpara saj, bazuar në aktin administrativ objekt gjykimi. Për këtë arsye, pretendimi i tij për vlerën më të lartë të objektit të kërkesëpadisë është haptazi i pabazuar.

55. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, i lidhur me të drejtën e aksesit, është haptazi i pabazuar.

56. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 23.2.2023.

Shpallur, më 23.3.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim,imi,

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Për çështjen me kërkuarë Petrit Hysin dhe objekt “*Shfuqizimin e vendimit nr. 895 (1373), datë 28.12.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si i papajtueshëm me Kushtetutën*”, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit lidhur me parimin e sigurisë juridike, ndaj çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Në mënyrë të përmbledhur, ne vlerësojmë se mënyra e arsyetimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka sjellë si pasojë që vendimi objekt gjykimi të jetë në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe konventore të të drejtave themelore të njeriut për këto arsye kryesore:

2.1. *Së pari*, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër nuk ka elaboruar, në kuptimin kushtetues, pretendimet thelbësore të kërkuarit, por ka analizuar kriteret ligjore të pavlefshmërisë absolute referuar Kodit të Procedurës Administrative, duke mos synuar të drejtën dhe duke i qëndruar gërmës së ligjit (*strictu sensu*).



2.2. *Së dyti*, kuadri ligjor i plotë për detyrimet për pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe analiza mbi efektet e tij ndaj kërkuarit, nuk gjenden në vendimin objekt kundërshtimi, fakt që konstatohet edhe duke iu referuar rrethanave të çështjes (*shih prg.2-15 të vendimit*), ku shumica ka evidentuar gjerësisht kuadrin ligjor të aplikueshëm në rastin e kërkuarit, për të arritur më pas në konkluzionin se ai ka pasur detyrimin për pagimin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore nga dispozitat ligjore në fuqi, dhe, në këtë kuptim, nuk ka cenim të sigurisë juridike.

2.3. *Së treti*, tek arsyetimi i vendimit objekt kundërshtimi, ajo gjykatë shprehet se administrata tatimore ka qenë e detyruar të zbatonte vendimin nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese (*shih fq. 15-16 të vendimit*), krejt ndryshe nga arsyetimi i shumicës që shprehet se nuk ka vend për zbatimin e vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese në rastin e kërkuarit.

2.4. *Së katërti*, mungesa e cilësisë dhe e parashikueshmërisë së legjislacionit në fuqi në rastin konkret, ku nuk parashikohej kategoria përjashtuese për profesionet përkatëse ndaj detyrimeve për pagim të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, por parashikohej se pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë të vetëm veprimtari ekonomike profesionale, nuk kanë detyrimin për të paguar këto kontribute, e ndërthurur me praktikën e ndjekur nga organet tatimore, si dhe interpretimin ligjor me vendimin objekt kundërshtimi të gjykatës, nuk kanë qartësuar kërkuarin lidhur me pozicionin e tij karshi pritshmërive të arsyeshme për zbatimin e ligjit.

3. Konkretisht, shumica, në lidhje me parimin e sigurisë juridike, ka vlerësuar se “[...] detyrimi i kërkuarit për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor buron nga dispozitat ligjore në fuqi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për sa kohë që vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës nuk ka krijuar boshllëk ligjor, ajo çmon se nuk jemi në rastet kur është e nevojshme ndërhyja e ligjvënësit për miratimin e një norme të re për parashikimin e një detyrimi të tillë. Nga ana tjetër, ky vendim i Gjykatës nuk është shprehur për të drejtat e kërkuarit dhe nuk ka sjellë ndonjë efekt mbi të, pasi as i ka njohur dhe as i ka mohuar ndonjë të drejtë. Gjykata vlerëson se organet tatimore kanë vepruar

në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, i cili nuk parashikon përjashtim nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kategorinë ku përfshihet kërkuari. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar (*shih prg. 41 të vendimit*).

4. Po ashtu, edhe në lidhje me standardin e arsytimit, ajo ka vlerësuar se: “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në vendimin e saj ka analizuar dhe vlerësuar rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke u shprehur në përfundim të gjykimit se aktet administrative objekt i kërkesëpadisë nuk preken nga shkaqe që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe për këtë arsye ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit. Po ashtu, ky vendim përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e organeve administrative, shkaqet e ngritura në kërkesëpadi, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë (*shih prg. 48 të vendimit*)

5. Fillimisht, theksojmë se bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata mund t’i shqyrtojë pretendimet për cenimin e të drejtave themelore të njeriut, procedurale ose substanciale, më vete ose të lidhura bashkë, në vështirim të procesit të rregullt ligjor. Në vlerësimin tonë, në rastin konkret shumica duhej të analizonte pretendimin për cenimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të lidhur ngushtë me pretendimin për cenimin e sigurisë juridike, dhe kërkuarit t’i jepej përgjigje në këtë drejtim.

6. Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës.

7. Sipas kësaj jurisprudence, arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët



përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 2 datë 11.2.2021; nr. 7, datë 7.2.2017; nr. 6, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë vetëm duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vështrim të këtyre standardeve, ne gjykojmë se duhen mbajtur në konsideratë këto fakte dhe rrethana të çështjes, me rëndësi të natyrës kushtetuese:

10.1. Ligji nr. 9136/2003, për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, ka pësuar ndryshime përmes ligjit nr. 143/2015. Ky ligj në nenin 6, pika 3, është ndryshuar duke parashikuar: “*Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për*

sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.”. Po ashtu, është ndryshuar dhe neni 9 që rregullon llogaritjen e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes.

10.2. Pas datës 29.1.2016, kur ka hyrë në fuqi VKM-ja nr. 37/2016, bazuar edhe në ligjin e sipërcituar, kërkuesi është përjashtuar nga detyrimi për pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për shkak se ishte pensionist, i regjistruar si person fizik i vetëpunësuar, i vetëm, që punonte në profesionin e avokatit, që përfshihej në profesionet e përcaktuara në VKM-në përkatëse.

10.3 Gjykata, me vendimin nr. 60, vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr. 143/2015, që ndryshonte nenin 9 të ligjit nr. 9136/2003, si dhe të VKM-së nr. 37/2016. Vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës hyri në fuqi në datën 20.9.2016, kur u botua në Fletoren Zyrtare.

10.4 Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr. 1, datë 25.1.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*akti normativ nr. 1/2017*). Ky akt normativ hyri në fuqi menjëherë. Nëpërmjet këtij akti normativ u bënë disa ndryshime në ligjin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme, dhe ndryshimi kryesor ishte pika 3 e nenit 6 të ligjit nr. 9136/2013, e cila u ndryshua për sa vijon: “*Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes.*”. Si rrjedhojë e aktit normativ nr. 1/2017, ligji për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme nuk parashikon më përjashtimin nga detyrimi për pagimin e kontributeve për sigurime shoqërore dhe të kujdesit shëndetësor për kategorinë e pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike të caktuara profesionale, sikundër ishte përcaktuar në nenin 6, pika 3 (*shih prg. 10.1 supra*).

10.5 Akti normativ nr. 1/2017 i sipërcituar në preambulë ka parashikuar: “Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, duke marrë në konsideratë boshllëkun ligjor të krijuar nga vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 4 të ligjit nr. 143/2015...”. Pra, qartësisht vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës ka



krijuar boshllëk ligjor, për sa kohë që edhe Këshilli i Ministrave në aktin normativ me fuqinë e ligjit nr. 1/2017 e ka parashikuar shprehimisht arsyen e miratimit të tij, që është boshllëku i krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese (*shih preambulën e aktit normativ*).

11. Në rastin konkret, është konstatuar se organet tatimore në vlerësimin e tyre i janë referuar vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës, dhe mbi bazën e këtij vendimi kanë arsyetuar se duke qenë se VKM-ja nr. 37/2016, që e përjashtonte kërkuesin nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është shfuqizuar, atëherë atij i lindte detyrimi t'i paguante këto kontribute që nga muaji shtator 2016, kur ka hyrë në fuqi vendimi nr. 60/2016. Po ashtu, edhe gjykata ka analizuar në këtë drejtim se “[...] administrata tatimore ka qenë e detyruar që të zbatonte vendimin nr. 60, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese, që kishte vendosur shfuqizimin e VKM-së nr. 37, datë 21.1.2016, si të papajtueshme me Kushtetutën”. Në këtë kuptim, Gjykata i vlerëson tërësisht të pabazuara pretendimet e palës paditëse se vendimi nr. 60/2016 i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të zbatohet nga ana e DRT Lezhë, pasi nuk shprehet në mënyrë eksplicite për shfuqizimin e nenit 9 të VKM nr. 37, datë 21.1.2016, në kushtet kur ky vendim i Gjykatës Kushtetuese e kishte shfuqizuar tërësisht VKM nr. 37, datë 21.1.2016 (*shih fagen 16 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër*). Në vijim, ajo është shprehur se kushtëzohet ligjërisht të analizojë vetëm nëse aktet administrative objekt gjykimi janë ose jo të pavlefshme, për më tepër që pala paditëse ka humbur të drejtën e padisë për të anatemuar gjyqësisht ligjshmërinë e akteve (pavlefshmërinë relative), pasi pretendimet nuk janë paraqitur brenda afatit kohor ligjor dhe gjithashtu nuk është e mundur rruga administrative e ankimit sipas ligjit (*shih f. 11 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë*). Më tej, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka analizuar dhe vlerësuar rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, duke u shprehur në përfundim të gjykimit se aktet administrative objekt i kërkesëpadisë nuk preken nga shkaqe që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të tyre. Për rrjedhojë, ajo ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit.

12. Duke iu referuar fakteve, vlen të theksohet se nga muaji janar i vitit 2016 deri në muajin

shtator të vitit 2016 kërkuesi nuk ka paguar dhe nuk ka pasur detyrime pagese për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, dhe ky mosdetyrim i ka ardhur pikërisht nga zbatimi i VKM-së nr. 37/2016, e cila përcaktonte edhe profesionet e përjashtuara, ku përfshihej dhe profesioni i avokatit, (*aneksi, lista 1, numri rendor 4*). Organet tatimore e kanë lidhur lindjen e detyrimit të kërkuesit për pagesën e kontributeve me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese, shtator 2016, e cila ka shërbyer si shkak ligjor për organet tatimore për të riaktivizuar detyrimet e kërkuesit si pensionist i vetpunësuar. Ky qëndrim është përqafuar edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, duke u shprehur se administrata tatimore ka qenë e detyruar të zbatonte vendimin nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese, krejt ndryshe nga sa ka argumentuar shumica se nuk ka vend për zbatimin e vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese në rastin e kërkuesit (*shih prg. 41 të vendimit*). Ndërkohë, një fakt tjetër që duhej të konsiderohej nga Gjykata Administrative në arsyetim, si pjesë e analizës ligjore të plotë të çështjes konkrete, është se pas vendimit të Gjykatës ka dalë akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 1/2017, që ka vendosur detyrimin për pensionistët e vetpunësuar të paguajnë kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Ky akt normativ ka ndryshuar nenin 6, pika 3, të ligjit nr. 9136/2003, ndryshuar me ligjin nr. 143/2015, i cili vazhdon të ishte në fuqi edhe pas vendimit nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese, dhe që parashikonte se pensionistët e vetpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor. Kjo do të thotë se ekzistonte një normë ligjore, e cila parashikonte që pensionistët e vetpunësuar nuk duhej të paguanin detyrime, nga ligji nr. 143/2015, dhe që me aktin normativ nr. 1/2017 u konsiderua që të hiqej si parashikim ligjor. Në këtë kuptim, në kohën që kërkuesit iu vunë detyrimet ekzistonte dispozita ligjore për përjashtimin e pensionistëve të vetpunësuar, po ashtu ekzistonte edhe delegimi për Këshillin e Ministrave sipas nenit 118 të Kushtetutës, por nuk kishte parashikime nënligjore konkrete për përcaktimin e profesioneve përkatëse, për të cilat



do të duhej të përjashtoheshin ata pensionistë që punonin si të vetëpunësuar.

13. Sipas gjyqtarëve në pakicë, ky kuadër ligjor i sipërpërmendur nuk ofronte garancitë e mjaftueshme që të mënjanoreshin mundësitë për abuzim dhe arbitraritet të autoriteteve publike për të drejtën kushtetuese të pronës së kërkuarit. Lidhur me ekzistencën e së drejtës së pronës, kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi sikundër dhe Gjykata ka theksuar pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlefshme me masën e detyrimit tatimor, gjobave dhe interesave, është një shumë e cila merret nga pasuria e tatimpaguesit, (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parashikon se “*çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*”. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GJEDNJ-së kërkohet që ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit për pronë të jetë e bazuar në ligj. Kjo gjykatë në jurisprudencën e saj është shprehur se “*vendosja e një gjobe në parim përbën ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga paragrafi i parë i Nenit 1 të Protokollit nr. 1, pasi privon personin e interesuar nga një pjesë e pronës, përkatësisht shumën që duhet të paguhet (shih Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 41087/98, § 50, KEDNJ 2001-VII). Për rrjedhojë, neni 1 i Protokollit 1 të Konventës është i aplikueshëm*” (*Valico S.r.l. k. Itali (dec.), aplikim nr. 70074/01*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka theksuar se ekzistenca e një baze ligjore në të drejtën e brendshme nuk mjafton, në vetvete, për të përmbushur parimin e ligjshmërisë dhe parashikueshmërisë (*East West Alliance Limited kundër Ukrainës, §167; Ünsper Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë, § 37; Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë [GC], § 96, Lekić kundër Sllovenisë [GC], § 95; Capital Bank AD kundër Bullgarisë, §134; Stolyarova kundër Rusisë, § 43*).

14. Në këtë kontekst, interpretimi i bërë nga organet tatimore mbi legjislacionin në fuqi, për detyrimet për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të kërkuarit dhe i përqaftuar përmes arsyetimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, nuk ishte interpretimi

më pajtues me Kushtetutën mes disa mënyrave të interpretimit, pasi legjislacioni në fuqi nuk ofronte qartësi dhe pritshmëri të arsyeshme për kërkuarin. Sikundër gjykata ka theksuar, lidhur me interpretimin pajtues, kjo metodë interpretimi kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për të gjitha argumentet e sipërpërmendura, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër duhej të kishte parashtruar kuadrin e plotë ligjor në lidhje me çështjen në gjykim, në mënyrë që arsyetimi të ishte koherent dhe logjik nga pikëpamja kushtetuese. Në këtë aspekt, ajo gjykatë nuk ka përmbushur detyrën e saj kushtetuese për ushtrimin e pushtetit gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes përcaktimit të fakteve dhe zbatimit të ligjit, që materializohet në arsyetimin e vendimit, si dhe nuk ka arsyetuar qartë rreth kuadrit ligjor të zbatueshëm. Për më tepër, përmes mungesës së arsyetimit të plotë mbi kuadrin e plotë ligjor, kërkuari nuk ka marrë përgjigje nga ajo gjykatë as për cenimin e parimit të sigurisë juridike.

16. Përveç sa më sipër, vlerësojmë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër do duhej të ushtronte funksionin e saj kushtetues dhe ligjor duke synuar të drejtën, përveçse interpretimin e ligjit lidhur me rastet e pavlefshmërisë absolute. Gjykata ka mbajtur qëndrim formalist, duke theksuar se për sa kohë kërkuari ka kërkuar në objektin e padisë pavlefshmërinë absolute të akteve, edhe kjo Gjykatë do të analizojë në këtë drejtim. Në rastin konkret, specifikat e kërkuarit si kategori pensionisti, por edhe fakti se ai, siç rezultoi, për shkak ligji, kishte vetëm një mundësi për shqyrtimin gjyqësor të çështjes së tij, pasi vendimi ka marrë formë të prerë që në shkallë të parë dhe ndaj tij nuk lejohej ankimi, detyronin që dhe kujdesi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër në drejtim të standardeve kushtetuese të ishte në nivele më të kënaqshme.

17. Si përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj gjykate dhe fakteve të natyrës kushtetuese,



vlerësojmë se kërkesa e kërkesit duhej pranuar dhe se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhej shfuqizuar.

Anëtarë: Marjana Semini, Sonila Bejtja, Elsa Toska

VENDIM
Nr. 64, datë 3.3.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA
SOLAR PARK 1” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAÏK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw, NË
ZONËN E ERSEKËS, BASHKIA
KOLONJË, QARKU I KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/1 prot., datë 1.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, qarku i Korçës”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 884 prot., datë 17.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1 A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.3, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 2.1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se është plotësuar pjesërisht dokumentacioni si vijon:

- *Neni 9, Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- *germa “b”*: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- *germa “b”*: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE letër interesi të rinovuar për mbështetjen financiare, ose të dokumentojë/informojë nëse ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me bankën. Gjithashtu, shoqëria duhet të sqarojë mënyrën e financimit në lidhje me shumën totale që disponon në llogari, pasi ajo që ka përcjellë nuk e mbulon të gjithë investimin.

- *Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës*

- *germa “c”*: Shoqëria duhet të paraqesë informacion rreth statusit të ecurisë së miratimit të pikës së lidhjes, pasi miratimi i pikës së lidhjes që aplikuesi ka depozituar është miratim vetëm në parim.

- Shoqëria duhet të dokumentojë se ku e bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 35 vjetësh të centralit fotovoltaik.

- Gjithashtu, shoqëria duhet të bëjë me dije mbi fillimin apo fazën në të cilën ndodhen punimet për ndërtimin e veprës.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar aneksit A të



“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën e Ersekës, bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 66, datë 3.3.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe neneve

10 dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/5 prot., datë 1.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 23, datë 9.2.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 10.2.2023 dhe 11.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.2.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germa “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.5.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,



modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Natre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 67, datë 3.3.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 257, DATË 21.12.2021 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.

120/4 prot., datë 1.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257 datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike’ dhe ‘Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258 datë 21.12.2021 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2021, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke i lënë kusht asaj që të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas sqarimeve dhe korrespondencës përkatëse të zhvilluar mes shoqërisë dhe ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 257/2021, rezulton se ajo e ka plotësuar tashmë këtë kusht.

- Duke qenë se është plotësuar kushti i vetëm i vendimit nr. 257/2021, nuk gjen më zbatim as pika 3, që ka të bëjë me të drejtën e ERE-s për rishikimin e këtij vendimit.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 68, datë 3.3.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 258, DATË
21.12.2021 "MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË 'YILDIRIM ENERGY
EUROPE ALBANIA' SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE"**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 120/4 prot., datë 1.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Albanian Energy Supplier 2' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike' dhe 'Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258 datë 21.12.2021 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Albanian Energy Supplier 2' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike'", konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 258, datë 21.12.2021, ndër të tjera, ka vendosur të licencojë shoqërinë "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k., në

veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke i lënë kusht asaj që të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike. Po ashtu, me fillimin e operimit, shoqëria "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k. të depozitojë në ERE sistemin IT.

- Pas sqarimeve dhe korrespondencës përkatëse të zhvilluar mes shoqërisë dhe ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 258/2021, rezultoi se ajo e ka plotësuar tashmë këtë kusht, ndaj si i tillë duhet të shfuqizohet.

- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258/2021, që ka të bëjë me sistemin IT, mbetet ende i paplotësuar nga shoqëria, por nga ana e saj është bërë me dije se po plotëson dokumentacionin që kërkohet për Marrëveshjen e Lidhjes dhe Marrëveshjen e Operimit të Rrjetit. Në këto kushte dhe duke qenë se nuk ka ndonjë përcaktim konkret mbi sistemin IT që i shërben shoqërisë për të ushtruar veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës, ky kusht mbetet ende i paplotësuar nga shoqëria.

- Në nenin 113 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021 "Mbi licencimin e shoqërisë "Albanian Energy Supplier 2" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".

2. Shoqëria "Yildirim Energy Europe Albania" sh.p.k. të raportojë periodikisht çdo muaj sipas kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE nr. 258/2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t' i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 43(423) datë 31.1.2023, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mhill Pal Degaj, i datëndjes 25.2.1964, lindur në Plan, Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetases Gjyste Prekë Degaj.

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 8, datë 10.1.2018, “Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 30.1.2018, bëhet korrigjimi të “Kushtet e Licencës për Aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror”, në nenin 16, pika 4, “Konfidencialiteti i informacionit”, si më poshtë vijon:

Neni 16, pika 4, ishte:

I licencuari do të hartojë dhe do të paraqesë pranë ERE- s procedurat për të siguruar zbatimin e kësaj pike 14...

Neni 16, pika 4, bëhet:

I licencuari do të hartojë dhe do të paraqesë pranë ERE- s procedurat për të siguruar zbatimin e kësaj pike...

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë